



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 111 Akti

Nr. 147 Vendimi
Tiranë, më 16.05.2019

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Valbona Sanxhaktari	Kryesues
Olsi Komici	Relator
Roland Ilia	Anëtar

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Etmonda Hoxha, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. John Leonardo, në Tiranë, në datën 13 maj 2019, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Arben Pasho**, prokuror/drejtues i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, i cili kërkoi konfirmimin në detyrë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/ b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar”;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2015, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, komisionerin Olsi Komici, dëgjoi subjektin e rivlerësimit, z. Arben Pasho, vëzhguesin ndërkombëtar, z. John Leonardo, pasi shqyrtoi në seancë dëgjimore publike në tërësinë e tij vlerësimin kalimtar ndaj subjektit Arben Pasho, i cili kërkoi konfirmimin e tij në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

Subjekti i rivlerësimit, z. Arben Pasho, ushtron detyrën e prokurorit/drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër dhe, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*.

Subjekti i rivlerësimit iu është nënshtruar procedurave të rivlerësimit duke u shortuar si subjekt me shortin e hedhur në datën 15.3.2018, në përputhje me Rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, short nga i cili rezultoi se subjekti do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr. 2, i përbërë nga komisionerët Valbona Sanxhaktari, Roland Ilia dhe Olsi Komici. Relator i çështjes u zgjodh me short komisioneri Olsi Komici.

Me vendimin nr. 1, datë 21.3.2018, trupi gjykues vendosi të fillojë hetimin administrativ sipas nenit 45, të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit, z. Arben Pasho, në lidhje me vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe rivlerësimin e aftësisë profesionale, si dhe caktoi kryesuesin e trupit gjykues, komisioneren Valbona Sanxhaktari. Në respektim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ nga relatori i çështjes.

Vëzhgues ndërkombëtar për këtë subjekt rivlerësimi është caktuar z. John Leonardo.

Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit (në vijim Komisioni) janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK) dhe Grupi i Punës në Prokurorinë e Përgjithshme.

Këto raporte janë administruar nga relatori në fillim të procesit të hetimit administrativ.

Në vijim, nga relatori i çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016.

Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me raportin dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, në datën 7.5.2019, vendosi përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit, z. Arben Pasho, si dhe njoftimin e këtij subjekti për t’u njohur me rezultatet e hetimit administrativ, si dhe dokumentet e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.

Subjekti i rivlerësimit u njoftua mbi të drejtën e tij për të paraqitur shpjegime për të kundërtën e rezultateve të hetimit apo të kërkojë marrjen e provave të reja apo thirrjen e dëshmitarëve.

Subjekti është njohur me përbërjen e trupit gjykues dhe ka deklaruar se nuk ka konflikt interesi me anëtarët e trupit gjykues.

II. SEANCA DËGJIMORE

Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore me njoftimin e bërë në rrugë elektronike në datën 8.5.2019.

Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, në datën 13.5.2019, ora 10:00, në sallën e konferencave, në Pallatin e Koncerteve, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. John Leonardo.

Në këtë seancë subjekti i rivlerësimit u paraqit personalisht. Ai parashtroi shpjegimet e tij, si dhe i depozitoi ato me shkrim pranë Komisionit.

Në përfundim, subjekti i rivlerësimit, z. Arben Pasho, kërkoi konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

Z. Arben Pasho ka qenë bashkëpunues gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, duke u përgjigjur kur i është kërkuar, sipas nenit 48, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Subjekti ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur. Subjekti i rivlerësimit ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni, është një proces kushtetues që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Për subjektin e rivlerësimit, z. Arben Pasho, bazuar në nenin 179/b, nenet Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në ligjin nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit përfshin të tria kriteret: vlerësimin e pasurisë; kontrollin e figurës; dhe vlerësimin e aftësive profesionale.

Pavarësisht se në kreun IV të ligjit nr. 84/2016 2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të kryer vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me këtë vlerësim pasuror, referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut II, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

A. VLERËSIMI I PASURISË

A/1 Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

Me shkresën nr. *** prot., datë 22.1.2018, në përputhje me nenin 33, të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Arben Pasho, i cili është subjekt deklarues në ILDKPKI që prej vitit 2003, me nr. indeksi ***, në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.

Subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar deklaratat e interesave private nga viti 2003 deri në vitin 2016 dhe, referuar ligjit nr. 84/2016, ka dorëzuar deklaratën e pasurisë - shtojca 2, në datën 30.1.2017. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera për çdo aset të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, ILDKPKI-ja ka konstatuar se:

- *deklarimi është i saktë, në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

A/2 Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

Bazuar në ligjin nr. 84/2016, objekti i vlerësimit të pasurisë është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të kontrollit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat private për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij. Referuar neneve 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja;
- b) deklaratën e pasurisë - shtojca 2 dhe deklaratat periodike të pasurisë ndër vite;
- c) provat e dorëzuara nga vetë subjekti në ILDKPKI;
- d) provat shkrese/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016 si nga: Ministria e Drejtësisë, Prokuroria e Përgjithshme, Banka e Shqipërisë dhe të gjitha bankat e nivelit të dytë, zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, shoqëria “****” sh.p.k., Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, drejtoritë rajonale të tatimeve, Qendra Kombëtare e Biznesit, Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a., shoqëria “Ujësjellës - Kanalizime” sh.a., zyra noteriale, DRSSH-të etj;
- e) deklarime dhe prova të dërguara nga subjekti i rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik;
- f) shpjegimet me shkrim të subjektit, si dhe shpjegimet në seancën dëgjimore.

Komisioni hetoi në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të ILDKPKI-së, si dhe të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me ligjin nr. 84/2016, hetim i cili konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur; (ii) verifikimin e burimeve të krijimit

të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të pasurive në pronësi apo përdorim; dhe (iv) evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarimeve të rreme apo të ndonjë situatë konflikti interesi, të parashikuar nga pika 5, e nenit 33, e ligjit nr. 84/2016.

➤ **Pasuritë e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën “Vetting”**

1. Apartament banimi, me sip. 78.8 m², me nr. pasurie ***, z.k. ***, vol. ***, f. ***, me adresë: lagjja “****”, p. ***, k. ***, Gjirokastër, blerë sipas kontratës së shitblerjes¹, datë 17.7.1996, në vlerën 2,000,000 lekë. Pjesa takuese: 100 %.

Burimi i krijimit:

- shuma e përfituar nga shitja e ish-hetuesisë (1,700,000 lekë);
- shuma 300,000 lekë kursime (nga pagat e bashkëshortëve).

Komisioni ka kryer korrespondencë me ZVRPP-në Gjirokastër², e cila ka konfirmuar pasurinë apartament, me sip. 78.8 m², me nr. pasurie ***, z.k. ***, vol. ***, f. ***, Gjirokastër, në emër të z. Arben Pasho (kjo pasuri rezulton e inskriptuar në favor të “BKT”-së me kontratë hipoteke nr. ***, datë 7.5.2012).

Apartamenti është përfituar nga kontrata e shitblerjes datës 17.7.1996³ me shitës F., dhe S.Xh., dhe blerës z. Arben Pasho, me çmimin 2,000,000 lekë. Në kontratë deklarohet se: “*ky çmim u likuidua*”.

Në lidhje me shumën prej 1,700,000 lekësh e përdorur si burim financiar për blerjen e apartamentit

Një pjesë e godinës së ish-hetuesisë është privatizuar nga subjekti nëpërmjet kontratës së privatizimit të datës 3.3.1994, për çmimin 3,720 lekë, me ish-Ndërmarrjen Komunale Banesa.

Dy pjesët e tjera të godinës janë privatizuar në të njëjtën datë 3.3.1994, përkatësisht nga shtetasit A. S., dhe S. M.

Me kontratën e shitblerjes të datës 9.7.1996⁴, shitësit Arben Pasho, A. S., dhe S. M., ia shesin të tria banesat shoqërisë “****” me çmimin 4,600,000 lekë.

Në lidhje me shumën prej 300,000 lekësh e përdorur si burim financiar për blerjen e apartamentit

Apartamenti është blerë nga subjekti në muajin korrik të vitit 1996. Nga analiza financiare, në lidhje me të ardhurat e krijuara nga subjekti dhe bashkëshortja e tij për periudhën nga viti 1990, kur subjekti i rivlerësimit ka filluar punë për herë të parë, deri në qershor të vitit 1996, duke marrë në konsideratë edhe shpenzimet e jetesës, rezulton se subjekti dhe personi i lidhur me të, bashkëshortja e tij, kanë pasur mundësi financiare për të kursyer shumën prej 300,000 lekësh që subjekti ka përdorur për të blerë këtë pasuri sipas kontratës së shitblerjes nr. 5808, datë 17.7.1996.

¹ Kontrata e shitblerjes nr. ***, datë 17.7.1996.

² Shkresa nr. ***prot., datë 14.1.2019 e ZVRPP-së Gjirokastër, drejtuar Komisionit; shkresa nr. *** prot., datë 1.2.2019 e ZVRPP-së Gjirokastër, drejtuar Komisionit; shkresa nr. ***prot., datë 15.3.2019, drejtuar Komisionit.

³ Kontrata e shitblerjes nr. ***, datë 17.7.1996.

⁴ Kontrata e shitblerjes nr. ***, datë 9.7.1996.

Viti	1990	1991	1992	1993	1994	1995	1996	Total
Të ardhura	8,600	10,500	10,800	196,387	225,850	462,134	175,432	1,089,703
Nga paga e subjektit	8,600	10,500	10,800	109,920	124,303	339,580	97,975	701,678
Nga paga e bashkëshortes	-	-	-	86,467	101,547	122,554	77,457	388,025
Shpenzime	6,020	7,350	7,560	137,471	158,095	323,494	122,802	762,792
Shpenzime jetese	6,020	7,350	7,560	157,110	180,680	369,707	140,346	871,762
Kursime	2,580	3,150	3,240	58,916	67,755	138,640	52,630	326,911

Për këtë apartament, në deklaratimet periodike vjetore, janë konstatuar disa mospërputhje deklarimi, për sa i përket vitit të krijimit, sipërfaqes, adresës në një vit, si dhe vlerës së tij.

Referuar analizës financiare të kryer nga Komisioni, konstatohet se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij, kanë pasur të ardhura të ligjshme dhe të mjaftueshme financiare për të justifikuar blerjen e këtij apartamenti.

Konkluzion

Komisioni, duke marrë në konsideratë shpjegimet e dhëna nga subjekti, i konsideron ato të mjaftueshme, duke krijuar bindjen se bëhet fjalë për të njëjtin apartament të blerë nga subjekti në vitin 1996.

Subjekti dhe personi i lidhur me të kanë pasur burime të ligjshme financiare për të justifikuar kursimet për blerjen e këtij apartamenti në shumën 326,911 lekë.

2. Shtesë organike me sip. 47 m², e ndërtuar në vitin 2011 mbi tarracën e pallatit me konstruksion të lehtë mbi apartament, me certifikatë pronësie. Nga kjo shtesë, 35 m² janë ambient qëndrimi dhe 12 m² janë verandë. Vlera totale është 500,000 lekë. Pjesa takuese: 100 %.

Burimi i krijimit: Subjekti nuk e ka deklaruar burimin e krijimit në deklaratën “Vetting”.

Nga korrespondenca me ZVRPP-në Gjirokastër⁵ konfirmohet se shtesa me sip. 47 m², e ndodhur në z.k. *** rezulton e regjistruar me pronar z. Arben Pasho, duke bashkëlidhur edhe dokumentacionin përkatës për këtë pasuri.

Në deklaratën periodike të pasurisë të vitit 2011 subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar këtë pasuri të ndërtuar në shumën 500,000 lekë.

Në deklaratën periodike të vitit 2014 subjekti e ka deklaruar këtë pasuri të ndërtuar në shumën 600,000 lekë.

Preventivi i punimeve i depozituar nga vetë subjekti, pasqyron se vlera e të gjithë investimit për ndërtimin e kësaj shtese është llogaritur në shumën totale 752,496 lekë.

⁵ Shkresa nr. *** prot., datë 2.5.2018, e Komisionit drejtuar ZVRPP-ve; shkresa nr. *** prot., datë 12.12.2018, e Komisionit drejtuar ZVRPP-së Gjirokastër; shkresa nr. *** prot., datë 14.1.2019, drejtuar Komisionit.

Në lidhje me mospërputhjet e konstatuara gjatë hetimit mbi vlerën e ndërtimit të kësaj shtese dhe koston e ndërtimit sipas preventivit, subjekti ka shpjeguar se materialet janë blerë me çmim më të lirë nga ai i parashikuar në preventiv, dhe se në vitin 2014 është deklaruar shtesa me vlerën 600,000 lekë për arsye se janë bërë punime shtesë në verandën me sip. 12 m², në vlerën 100,000 lekë.

Lidhur me burimin e krijimit të shumave 500,000 lekë dhe 100,000 lekë, subjekti ka shpjeguar se këto shuma monetare janë krijuar si rezultat i të ardhurave nga pagat e tij dhe të bashkëshortes për vitet 2011 dhe 2014.

Analiza financiare për vitin 2011

Përshkrimi	2011
Të ardhurat	2,221,667
Nga pagat dhe shpërblimet, subjekti	1,338,482
Të ardhura nga bonusi për karburantin	35,000
Nga pagat e bashkëshortes	761,650
Të ardhura nga interesat bankare	86,535
Detyrime	0
Shpenzime	611,957
Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së	307,395
Shpenzime udhëtimi	19,362
Shpenzime shkollimi	270,000
Shpenzime për karburantin	15,200
Pasuri	695,315
Kursime (pakësim/shtesa likuiditeti)	195,315
Shtesë apartamenti sip. 47 m ² , lagjja “****”	500,000
Të ardhura + detyrime - shpenzime – pasuri	914,395

Nga analiza financiare e vitit 2011, subjekti i rivlerësimit rezulton me një balancë financiare pozitive në shumën 914,395 lekë.

Konkluzion

Në përfundim, Komisioni arriti në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime bindëse në lidhje me këtë pasuri dhe, së bashku me personin e lidhur me të, bashkëshorten e tij, kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar shpenzimet e kryera përgjatë vitit 2011.

3. Automjet, tip “Mercedes Benz”, me targa AA ***, blerë në datën 3.9.2012, për çmimin 6,600 euro (5,000 euro blerje + 1,600 euro doganë). Pjesa takuese: 100 %.

Burimi i krijimit: Huaja e marrë nga shtetasi R.Z., në shumën 7,000 euro.

Në dokumentacionin e përcjellë nga DPSHTRR-ja për këtë mjet rezulton *fatura e blerjes* së mjetit lëshuar nga pronari i mjetit I. D. (shtetas italian), në datën 3.9.2012 dhe blerësi Arben Pasho, me çmim 5,000 euro.

Deklarata doganore për pagesën e taksës doganore për këtë mjet në vlerën 141,004 lekë mban datën 6.9.2012.

Certifikata e pronësisë të këtij mjeti që vërteton se z. Arben Pasho është pronar i automjetit tip “Mercedes Benz”, me targa AA ***, mban datën 7.9.2012.

Në deklaratën periodike të vitit 2012 subjekti ka deklaruar: “blerje mjeti, tip Mercedes Benz 320, viti i prodhimit 2003, me targa AA ***, me vlerën 5,000 euro blerje + 1,300 euro dogana + 300 euro taksa = 6,600 euro”. Nuk është deklaruar burimin e krijimit.

Në deklaratën “Vetting” subjekti ka deklaruar blerjen e këtij automjeti në shumën 6,600 euro (5,000 euro blerje + 1,600 euro taksa), dhe si burim krijimi ka deklaruar hua pa interes marrë nga z. R.Z., sipas deklaratës noteriale të datës 20.12.2012.

Në deklaratën noteriale të huas⁶, datë 20.12.2012, shtetasi R.Z., deklaron se në datën 20.9.2012 i ka dhënë z. Arben Pasho pa interes shumën 7,000 euro (ndërkohë në deklaratën noteriale të datës 24.12.2015, me deklarues Arben Pashon, ky i fundit deklaron se i ka dhënë z. R.Z., shumën 6,000 euro brenda zyrës noteriale si detyrim që ia kishte marrë borxh dhe detyrimi i mbetur ndaj huadhënësit R.Z., ishte në shumën 1,000 euro).

Për sa më lart, rezulton se automjeti tip “Mercedes Benz” është blerë në datën 3.9.2012 dhe pagesa doganore është bërë në datën 6.9.2012, ndërkohë që huan prej 7,000 euro, subjekti e ka marrë në datën 20.9.2012.

Analizë huas së shumës 7,000 euro dhënë subjektit të rivlerësimit, z. Arben Pasho, nga shtetasi R.Z., në datën 20.9.2012

Për të vërtetuar mundësitë financiare të huadhënësit R.Z., për dhënien e shumës prej 7,000 euro, Komisioni ka kryer korrespondencë me bankat e nivelit të dytë, Drejtorinë Tatimore Gjirokastër dhe Bashkinë Gjirokastër⁷.

Gjithashtu, Komisioni i ka kërkuar subjektit që të depozitojë dokumentacionin ligjor provues në lidhje me mundësitë financiare të shtetasit R.Z., për dhënien e huas.

Subjekti ka deklaruar: “*Shtetasi R. Z. ka realizuar të ardhura nga burime të ligjshme nga ushtrimi i aktivitetit në fushën e tregtisë duke iu referuar certifikatës së lëshuar për shoqërinë ‘***’ sh.p.k. nga Dega e Tatimeve e Rrethit Gjirokastër, si dhe tregti asetesh imobiliare dhe këmbim valutor*”.

Komisioni, pas hetimit të kryer në lidhje me aktivitetin ekonomik financiar të z. R.Z., dhe mundësisë së tij financiare për dhënie huaje subjektit, i ka kaluar subjektit barrën e provës për të provuar burimin e ligjshëm të shumës 7,000 euro, dhënë hua nga shtetasi R.Z., për blerjen e automjetit.

Subjekti, pas kalimit të barrës së provës, depozitoi në Komision dokumentacion tjetër shtesë për z. R.Z., që vërteton mundësitë financiare të këtij të fundit për dhënien e huas.

Si dokumentacion justifikues, subjekti ka depozituar:

- a) kontratë qiraje për një magazinë me sip. 372 m², datë 21.1.2003, me afat 5-vjeçar, me pagesë 280,000 lekë në vit;

⁶ Deklarata noteriale e huas nr. ***, datë 20.12.2012.

⁷ Shkresa nr. *** prot., datë 28.3.2019, e Bashkisë Gjirokastër, drejtuar Komisionit; shkresa nr. *** prot., datë 29.3.2019, e DRT-së Gjirokastër drejtuar Komisionit; shkresa nr. ***prot., datë 26.12.2018, e “BKT”-së.

- b) kontratë qiraje, datë 26.3.2008, me afat 2-vjeçar, me pagesë 250,000 lekë në vit;
- c) kontratë qiraje, datë 15.5.2010, me afat 1 vit, me pagesë 250,000 lekë në vit;
- d) kontratë qiraje, datë 28.3.2011, me afat 1 vit, me pagesë 250,000 lekë në vit.

Subjekti ka depozituar edhe dokumentacion bankar që vërteton pagesën e tatimit në lidhje me kontratat e qirasë.

Nga dokumentacioni i paraqitur rezultoi se shtetasi R.Z., për periudhën 2003 – 2011, ka përfituar të ardhura nga qiraja në vlerën totale prej 2,160,000 lekësh, për të cilën është paguar dhe tatimi në burim.

Në deklaratën periodike të pasurisë të vitit 2012 subjekti deklaroi blerjen e dy automjeteve, “Citroen” dhe “Benz”, përkatësisht me burime financiare krijimi, kursimet nga pagat dhe hua pa interes marrë shtetasit R.Z.

Automjeti tip “Citroen” rezultoi i blerë nga djali i subjektit të rivlerësimit, z. O.P., me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 20.5.2012, për çmimin 1,500 euro, e cila më pas është shitur në datën 30.10.2013, për çmimin 2,000 euro.

Analiza financiare për vitin 2012

Përshkrimi	2012
Të ardhurat	2,862,813
Nga pagat dhe shpërblimet, subjekti	1,541,688
Të ardhura nga bonusi për karburantin	420,000
Nga pagat e bashkëshortes	816,530
Të ardhura nga interesat bankare	84,595
Të ardhura nga shitja e mjetit ⁸	0
Detyrime	978,040
Hua e marrë pa interes	978,040
Shpenzime	939,673
Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së	307,395
Shpenzime udhëtimi	11,178
Shpenzime shkollimi	270,000
Shpenzime mobilimi	180,000
Shpenzime për karburantin	171,100
Pasuri	1,193,159
Kursime (pakësim/shtesa likuiditeti)	61,427
Automjet “Citroen mod.C-3”, viti 2003, AA ***	209,580
Autoveturë “Benz”, viti 2003, AA ***	922,152
Të ardhura + Detyrime - Shpenzime – Pasuri	1,708,021

⁸ Të ardhura nga shitja e automjetit tip “BMW”. Subjekti ka deklaruar se këtë mjet ia ka shitur të vëllait për vlerën 280,000 lekë, pa kontratë.

Të ardhurat e deklaruara nga shitja e automjetit tip “BMW”, me targa TR ***, nuk janë përfshirë në analizën financiare për vitin 2012, për arsye se ato nuk janë konsideruar si të ardhura të ligjshme, pasi shitja e mjetit është bërë pa dokument ligjor (automjeti tip “BMW” është shitur nga subjekti, pa letra, tek i vëllai, por është deklaruar në deklaratën vjetore të vitit 2012 vlera e shitjes prej 280,000 lekësh, si dhe është depozituar deklaratë noteriale e vitit 2019 e vëllait të subjektit sipas së cilës ky i blen subjektin automjetin e mësipërm për shumën 280,000 lekë në vitin 2012).

Në lidhje me konstatimin e Komisionit se huaja marrë shtetasit R.Z., në datën 20.9.2012, nuk ka ekzistuar në momentin e blerjes së mjetit, për arsye se mjeti rezulton i blerë në datën 3.9.2012 dhe në datën 6.9.2012 është bërë pagesa doganore, subjekti ka dhënë shpjegime të detajuara se ai ka dashur që të ishte i garantuar fillimisht se mjeti nuk kishte probleme me dokumentacionin, duke e testuar këtë fakt me kalimin e mjetit në pikën doganore të Kakavijës, dhe më pas është proceduar me kryerjen e pagesës.

Për sa i përket analizës financiare të vitit 2012 subjekti bashkë me personin e lidhur me të kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme financiare për të justifikuar shpenzimet e kryera përgjatë vitit 2012.

Nga hetimi rezultoi se për të justifikuar aftësinë huadhënëse të shtetasit R.Z., subjekti paraqiti 4 kontrata qiraje të shoqëruara me dokumente bankar të cilat vërtetojnë pagesën e tatimit në burim, ku për periudhën 01.02.2003 deri 31.01.2012 ai ka realizuar të ardhura në shumën 2,160,000 lekë.

Konkluzion

Komisioni, pasi mori në analizë dokumentacionin e përcjellë nga DPSHTRR-ja, si dhe shpjegimet e dhëna nga subjekti në lidhje me mospërputhjen e datave të veprimeve të bëra për blerjen e mjetit me datën e dhënies së huas, konkludoi se subjekti ka dhënë shpjegime bindëse në lidhje me këtë konstatim.

Subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme financiare për të justifikuar shpenzimet e kryera përgjatë vitit 2012.

Komisioni vlerësoi se subjekti ka paraqitur dokumentacion ligjor justifikues të mjaftueshëm për të provuar burimin e ligjshëm të shumës prej 7,000 euro, dhënë hua subjektit në vitin 2012, nga shtetasi R.Z., në cilësinë e personit tjetër të lidhur.

4. Gomone peshkimi blerë në vitin 2014, e përdorur pa dokumentacion në bashkëpronësi me z. Dh.K., aktualisht e amortizuar dhe nuk mund të përdoret, me vlerë 2000 euro dhe me pjesë takuese 50 %.

Burimi i krijimit: Kursime nga pagat.

Nga korrespondenca e kryer me Drejtorinë e Përgjithshme Detare⁹ konfirmohet se në emër të z. Arben Pasho rezulton i regjistruar mjeti lundrues “****” me nr. regjistrimi ***.

⁹ Shkresë e Komisionit nr. *** prot, dt.13.12.2018 drejtuar DPDetare për mjete lundrimi në emër të Arben Pasho; Shkresa e DP Detare nr. ***prot, dt.20.12.2018 drejtuar Komisionit ka vënë në dispozicion dokumentacionin e regjistrimit të mjetit të lundrimit në emër të subjektit A.Pasho.

Nga dokumentacioni i Drejtorisë së Përgjithshme Detare rezulton se sipas deklaratës së shitjes së datës 16.07.2014, z. A.B. (shtetas shqiptar), banues në Modena Itali i ka shitur këtë mjet subjektit me çmimin 1,000 euro. Në bazë të certifikatës së mjetit rezulton se ky mjet lundruar është i regjistruar me pronar, z. Arben Pasho.

Subjekti, në shpjegimet e tij, ka deklaruar se me shtetasin Dh.K., kanë miqësi familjare dhe se kanë në bashkëpronësi një varkë peshkimi për të cilën janë paguar 1,000 euro nga shtetasi Dh.K., dhe 1,000 euro janë paguar nga vetë subjekti.

Komisioni i ka kërkuar shpjegime subjektit në lidhje me mospërputhjen e çmimit të deklaruar në deklaratën “Vetting” në vlerën 2,000 euro në bashkëpronësi, ndërkohë që referuar dokumentacionit të përcjellë nga Drejtoria e Përgjithshme Detare, fatura për blerjen e mjetit është në vlerën 1,000 euro.

Subjekti ka deklaruar se për këtë mjet është paguar vlera 2,000 euro, nga 1,000 secili, duke e argumentuar diferencën prej 1,000 euro me riparimin e disa defekteve teknike të mjetit.

Konkluzion

Komisioni, pasi analizoi dokumentacionin e përcjellë nga Drejtoria e Përgjithshme Detare, si dhe deklarimet e subjektit të shoqëruara dhe me dokumentacion, nuk konstatoi ndonjë problematikë në lidhje me këtë pasuri.

➤ Pasuritë e deklaruara nga personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit, djali i tij, O.P.

1. Truall me sip. 168 m², ku është ndërtuar shtëpi banimi me sip.93 m², në Gjirokastrë, me vlerë 22,850 lekë. Pjesa takuese: 100 %.

Burimi i krijimit:

- testamenti¹⁰ i vitit 2010 i trashëgimlënësit E.Z., (ka ndërruar jetë në shtator 2014);dhe
- kontratë dhurimi e vitit 2015 e znj. E.Z., (L.,) dhe znj. B.Z., (D.,) me dëshminë e trashëgimisë ligjore¹¹.

Nga korrespondenca me ZVRPP-në Gjirokastrë¹² dhe nga dokumentacioni shoqëruar konfirmohet se pasuria shtëpi banimi, me nr. ***, z.k. ***, vol. ***, f. ***, me sipërfaqe ndërtimi 93 m² dhe truall me sip. 168 m², e ndodhur në Gjirokastrë, me bashkëpronarë S.Z., M.P., O.P., rezulton të jetë tjetërsuar në favor të z. O.P., me kontratën e dhurimit¹³ të datës 17.4.2015.

Konkluzion

Nga hetimi i Komisionit rezulton se deklarimet e subjektit përputhen me dokumentacionin e vënë në dispozicion të Komisionit.

2. Ambient, dhomë me sip.7.33 m², “**”, si dhe korridor i përbashkët 4 m², në lagjen “****”, Gjirokastrë, në vlerën 2280 lekë. Pjesa takuese: 100 %.**

¹⁰ Testamenti nr. *** rep., datë 25.10.2010.

¹¹ Dëshmia e trashëgimisë nr. ***, datë 11.3.2015.

¹² Shkresa nr. *** prot., datë 2.5.2018, e Komisionit, drejtuar ZVRPP-ve; shkresa nr. *** prot., datë 12.12.2018, e Komisionit, drejtuar ZVRPP-së Gjirokastrë; shkresa nr. ***prot., datë 14.1.2019, e ZVRPP-së Gjirokastrë, drejtuar Komisionit.

¹³ Kontrata e dhurimit nr. ***, e datë 17.4.2015.

Burimi i krijimit:

- testamenti i vitit 2010 me trashëgimlënës, z. E.Z., (ndërruar jetë shtator 2014);dhe
- testamenti i vitit 2014¹⁴ me trashëgimlënëse testamentare znj. S.Z., në favor të shtetasit O.P.

Komisioni ka kryer korrespondencë¹⁵ me ZVRPP-në Gjirokastrë e cila ka konfirmuar se kjo pasuri nuk rezulton e regjistruar pranë kësaj zyre.

Subjekti ka depozituar dokumentacionin përkatës nga ku rezulton se me kontratën e privatizimit të datës 9.1.1992, znj. S.Z., ka blerë nga Ndërmarrja Komunale e Shërbime Gjirokastrë tek ***, dhomën me sipërfaqe 7.33 m², me çmim 2,880 lekë.

Me kontratën e shitblerjes të datës 26.6.1992, znj. S.Z., ka blerë nga Ndërmarrja Komunale e Shërbime Gjirokastrë, tek ***, dhomën me sip. 4 m², me çmim 1,171 lekë.

Me testamentin e datës 25.11.2010, trashëgimlënësja testamentare, znj. S.Z., ka caktuar përfitues nipin e saj, O.P., i cili përfiton këto pasuri të paluajtshme.

Konkluzion

Nga hetimi i Komisionit rezulton se deklaratimet e subjektit përputhen me dokumentacionin e vënë në dispozicion të Komisionit.

3. Apartament me sip. 123.5 m², në *, ***, Tiranë, përfituar nga kontrata e porosisë së znj. S.Z., në vitin 2014, me vlerë 31,600 euro. Pjesa takuese: 100 %.**

Burimi i krijimit:

- testamenti i vitit 2014 me trashëgimlënëse testamentare znj. S.Z., e cila i lë trashëgim pasuritë dhe të drejtat reale që rrjedhin prej tyre, nipit të saj O.P.; dhe
- kontrata e porosisë¹⁶ lidhur me sipërmarrës shoqërinë “***” sh.p.k dhe znj. S.Z., në vitin 2014.

Komisioni ka kryer korrespondencë me ZVRPP-në Tiranë, shoqërinë “***” sh.p.k., Drejtorinë Rajonale Tatimore Gjirokastrë, të gjitha bankat e nivelit të dytë, si dhe institucionet e tjera financiare,¹⁷.

ZVRPP-ja Tiranë ka konfirmuar se nuk rezultojnë të regjistruara pasuri të paluajtshme në emër të shtetasit O.P.

Shoqëria “***” sh.p.k., ka dërguar në Komision kontratën e sipërmarrjes së lidhur midis saj dhe porositëses S.Z., për apartamentin me sip.123.5 m², të ndodhur në ***, Tiranë, lidhur në datën 29.10.2014, me çmimin në total 31,600 euro.

¹⁴ Testamenti nr. ***, datë 17.4.2015.

¹⁵ Shkresa nr. *** prot., datë 2.5.2018, e Komisionit drejtuar ZVRPP-ve; shkresa nr. *** prot., datë 12.12.2018, e Komisionit, drejtuar ZVRPP-së Gjirokastrë; shkresa nr. *** prot., datë 14.1.2019 e ZVRPP-së Gjirokastrë drejtuar Komisionit.

¹⁶ Kontrata e porosisë nr. ***, datë 29.10.2014.

¹⁷ Shkresa nr. *** prot., datë 18.05.2018, e ZVRPP-së Tiranë; shkresa e datës 27.12.2018, e shoqërisë “***” sh.p.k.; shkresa me nr. *** prot, datë 05.02.2019, e Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Gjirokastrë.

Në kontratën e sipërmarrjes tek neni 3, “Çmimi i kontratës dhe mënyra e pagesës” është pasqyruar fakti se porositësi S.Z., ka likuiduar këstet si më poshtë:

- kësti i parë me vlerë 15,000 euro, në datën 8.1.2008;
- kësti i dytë me vlerën 11,000 euro, në datën 9.4.2008;
- kësti i fundit prej 5,600 euro likuiduar nga e bija M.P., tek “ProCredit Bank”, në datën 23.6.2014.

Shoqëria “***” sh.p.k. ka vënë në dispozicion të Komisionit mandatarkëtimet ku vërtetohet (1) pagesa prej 15,000 euro, e bërë në datën 8.1.2008; (2) pagesa prej 11,000 euro, e bërë në datën 8.4.2008; si dhe (3) mandatarkëtimi i lëshuar nga “ProCredit Bank”, në datën 23.6.2014, në shumën 5,600 euro, me përshkrimin: “depozitoi B.B., për M.P., pagesë kësti apartamenti”.

Komisioni i ka kërkuar subjektit shpjegime në lidhje me pagesën e këstit 5,600 euro, i cili referuar mandatpagesës së “ProCredit Bank” rezulton me përshkrimin “depozitoi B.B., për M.P.”.

Subjekti, në përgjigje të tij ka deklaruar se për shkak të gjendjes së rënduar shëndetësore të të ndjerës S.Z., pagesa prej 5,600 euro i është dorëzuar *cash* shtetasit B.B., nga bashkëshortja e subjektit, znj. M.P., në ambientet e shoqërisë “***” sh.p.k, në ***.

Kontrata e porosisë është formalizuar në datën 24.10.2014 pasi është paguar shuma totale, jo në momentin e dorëzimit të këstit të tretë paguar në “ProCredit Bank”.

Komisioni i ka kërkuar subjektit të japë shpjegime në lidhje me arsyen e kryerjes së pagesave të këstit të parë prej 15,000 euro dhe këstit të dytë prej 11,000 euro nga znj. S.Z., në vitin 2008, pra 6 vite para se të lidhej kontrata e porosisë në vitin 2014.

Subjekti në përgjigjen e tij sqaron se pagesat e dy kësteve, shumë afër vlerës totale, janë bërë në mirëbesim vetëm me mandatpagesa dhe jo me kontratë porosie, për shkak të lidhjeve miqësore mes palëve, si dhe për shkak të çmimit të favorshëm të ofruar.

Komisioni i ka kërkuar subjektit që të provojë me dokumentacion ligjor justifikues aftësitë paguese të znj. S.Z., për të paguar shumën prej 31,600 euro për blerjen e këtij apartamenti.

Për të provuar aftësitë paguese të znj. S.Z., subjekti ka depozituar si dokumentacion justifikues ligjor:

- vërtetimin e lëshuar nga DRSSH-ja Gjirokastrë që vërtetohen se znj. S.Z., ka pasur të ardhura pensioni për periudhën dhjetor 1992 – dhjetor 2015;
- vërtetim lëshuar nga DRSSH-ja Gjirokastrë që vërtetohen se z. E.Z., ka pasur të ardhura pensioni për periudhën dhjetor 2003 – dhjetor 2014;
- dy dokumente me emërtimin “tërheqje elektronike” nga data 23.6.2011 – 25.7.2011, duke dhënë gjendje llogarie në monedhën dollar;
- kontratë shitje e datës 16.2.2000 me shitës A.L., dhe blerës Th.N., për pasurinë me sip. 44 m², të ndodhur në katin e parë të pallatit, në Gjirokastrë, me çmim 3,900,000 lekë, likuiduar jashtë zyrës noteriale.
- deklaratë noteriale e datës 16.1.2019 lëshuar nga shtetasi N.M., që deklaroi: “ *Kam ushtruar aktivitetin si ekonomist (financier) për periudhën nga 1 tetori 1993 – 31.03.2001 në zyrën e marrë me qira nga znj. S.Z. Zyra është marrë me qira mujore 10,000 lekë. E lëshoj këtë deklaratë sepse kontratën e qirasë nuk e kemi formalizuar me një akt noterial.*”;

- dëshmi e lëshuar nga shtetasit A., dhe E.L., (E.L., e bija e E., dhe S.), e datës 16.1.2019, para noterit publik në SHBA. Në këtë deklaratë dy shtetasit e mësipërm, të cilët jetojnë në SHBA, kanë deklaruar: *“Në 18 shkurt 2000 kanë shitur pronën e tyre kafene me vendndodhje në adresën: Lagjja “***”, Gjirokastër tek z. Th.A, në shumën 3,900,000 lekë. Në mars të vitit 2000 ia kemi dhënë një pjesë të këtyre lekëve zotit E., dhe znj. S. Z., (prindërit e E.L.) në shumën 2,500,000 lekë të cilën ata e përdorën për të blerë apartamentin, në ***, Tiranë”*.

Komisioni i është drejtuar Drejtorisë Rajonale Tatimore Gjirokastër për të verifikuar nëse ka të dhëna mbi pagimin e detyrimeve tatimore që rrjedhin nga marrëdhënia e qirasë për periudhën 1.10.1993 – 31.3.2000 për shtetasen S.Z.

Drejtoria Rajonale Tatimore Gjirokastër, në përgjigje të saj, ka sqaruar se kjo drejtori ka hyrë në sistem në datën 1.11.2009 dhe për periudhën 1.10.1993 – 31.3.2001, nuk disponon të dhëna.

Komisioni i ka kërkuar subjektit të dokumentojë shumën prej 3,900,000 lekësh që kanë përfituar shtetasit A., dhe E.L., nga shitja e dyqanit në Gjirokastër, si dhe dokumentimin e shumës prej 2,500,000 lekësh që i është dhënë S., dhe E.Z., nga A., dhe E.L.

Subjekti ka shpjeguar: *“Pagesa e shumës 3,900,000 lekë, e përfituar nga A.L., dhe E.L., dokumentohet me “kontratën e shitjes”, me nr. ***, datë 16.2.2000, me palë: shitës A. L., i biri S., i datëlindjes. 1966 dhe blerës z. Th. N., i biri S., i datëlindjes 1950, me banim në Gjirokastër”*.

Me deklaratën noteriale në datën 2.2.2019, dhënë përpara noterit në SHBA, shtetasit E., dhe A.L., kanë deklaruar se shumën prej 2.500.000 lekësh ua kanë dhënë në cash E., dhe S.Z., prindërit e E.L., duke bashkëlidhur me deklaratën edhe kontratën e shitjes nr. ***, datë 16.2.2000.

Komisioni i ka kërkuar subjektit shpjegime nëse shtetasit A., dhe E.L., shumën prej 2, 500,000 lekësh ua kanë dhuruar, dhënë hua, apo ndonjë shpjegim tjetër, shtetasve E., dhe S.Z., si dhe ku është disponuar kjo shumë, nga viti 2000 deri në 2008 kur është blerë apartamenti në ***.

Subjekti ka shpjeguar se në dijeninë e tij A., dhe E.L., shumën e mësipërme ua kanë dhuruar E., dhe S.Z., për të garantuar mirëqenien në vijim, në rrethanat kur ata do të ndodheshin në SHBA dhe nuk do të kishin mundësi për tu përkujdesur.

Shuma e mësipërme në dijeninë e subjektit, nuk iu është kthyer shtetasve A., dhe E.L., dhe se shtetasit E., dhe S.Z., e kanë disponuar atë në cash në shtëpi.

Subjekti, pas kalimit të barrës së provës ka deklaruar: *“Në vitin 2008 prindërve të bashkëshortes i është propozuar nga shtetasi A.D., blerja e një apartamenti në *** me çmimin 31,600 euro, çmim për të cilin S., dhe E.Z., kanë qenë dakord. Për të plotësuar çmimin e blerjes, prindërit e bashkëshortes kanë përdorur si burim shumën 2,500,000 lekë të dhuruara nga A., dhe E.L., shumë kjo që është disponuar cash. Vajza e tyre, znj. E.L, i ka pasur mundësitë financiare për t’ia dhuruar prindërve këtë shumë. Bashkëshortët A., dhe E.L., e kanë përfituar shumën 3,900,000 lekë nga shitja e një pasurie të paluajtshme në vitin 2000. Gjithashtu, ata përveç kësaj shume kanë disponuar dhe të ardhura të konsiderueshme të cilat i kishin depozituar në vlerë aksionesh në Greqi ku këto shuma janë tërhequr dhe konvertuar në valutën dollarë në vlerën 140,000 USD të cilën e kanë transferuar në llogarinë e tyre*

bankare në SHBA, dhe kjo gjendje financiare e mirë e tyre u jepte mundësinë që t'i linin S., dhe E.Z., shumën 2,500,000 lekë”.

Pas kalimit të barrës së provës, subjekti ka deklaruar edhe të ardhurat nga qiraja ndërmjet shtetasit N.M., ekonomist, dhe znj. S.Z., për shumën 10,000 në muaj, për periudhën 01.10.1993 – 31.03.2001, dhe për të vërtetuar këtë fakt ka paraqitur deklarata noteriale të vitit 2019 të disa shtetasve (I.K., B.D. dhe B.Ç.) të cilët kanë deklaruar se shtetasi N.M., ka ushtruar aktivitetin e tij, si ekonomist, në ambientin e dhënë me qira nga znj.S.Z.

Nga dokumentet e ardhura në Komisionit nga “Tirana Bank” ka rezultuar se nga shtetasi A. L., në datën 21.2.2000, është depozituar shuma prej 5,120,000 lekësh.

Komisioni rihapi hetimin dhe i kërkoi subjektit shpjegime në lidhje me burimin e krijimit të shumës së sipërpërmendur në llogari të z. A.L., si dhe dokumentacion ligjor justifikues për krijimin e kësaj shume. Këto shpjegime u kërkuan në funksion të provueshmërisë së dhurimit nga ata të shumës prej 2,500,000 lekësh S., dhe E.Z.

Subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës në lidhje me këtë konstatim të Komisionit, ka deklaruar se shtetasi A.L., këto të ardhura i ka krijuar nga aktiviteti tregtar që ka ushtruar që nga vitet 1992 deri në vitin 2000. Për këto subjekti ka paraqitur dokumentacion të marrë nga Drejtoria Rajonale Tatimore Gjirokastrë, ISSH-ja dega Gjirokastrë, Degës së Doganës Kakavijë, etj., nga ku është arritur të provohet një pjesë e kësaj shume, ndërsa pjesa tjetër e dokumentacionit nuk mund të jetë i disponueshëm për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar.

Shpjegimet e dhëna nga subjekti dhe dokumentacioni përkatës krijuan bindjen te Komisioni që shuma prej 2,500,000 lekësh dhënë shtetasve E., dhe S.Z., vjen nga një burim i ligjshëm që është kontrata e shitjes nr. ***, datë 16.2.2000.

Si burime financiare për justifikimin e shumës prej 31,600 euro të paguara nga znj. S.Z., për porositjen e apartamentit, në ***, Tiranë, subjekti ka deklaruar: i) shuma prej 2,500,000 lekë, dhënë S., dhe E.Z., nga A., dhe E.L.; ii) të ardhurat nga qiraja me shtetasin N.M., për periudhën 01.10.1993 – 31.03.2001, për çmimin 10,000 lekë/muaj; iii) kursimet nga të ardhurat nga pagat dhe pensionet e shtetasve E., dhe S.Z.

Nga vlerësimi i dokumentacionit të depozituar nga subjekti, si dhe nga deklaratimet e tij, rezultoi se shtetasi A., dhe E.L., kanë të ardhura të konsiderueshme financiare për të dhuruar shumën 2,500,000 lekë S., dhe E.Z. Kjo marrëdhënie financiare nuk rezultoi e provuar me ndonjë dokument, por nisur nga fakti se ata ishin persona shumë të afërt të familjes, Komisioni pranoi shpjegimet e dhuruesve edhe për faktin se ato para i janë dhënë prindërve të njërit prej dhuruesve dhe se kjo marrëdhënie nuk kishte ndonjë arsye për tu dokumentuar në atë kohë.

Për sa i përket të ardhurave nga qiraja subjekti nuk paraqiti ndonjë kontratë qiraje apo dokument provues të asaj kohe midis znj. S.Z., dhe qiramarrësit N.M. Subjekti paraqiti si provë deklaratë noteriale të vitit 2019 të qiramarrësit lidhur me qiranë mujore në shumën prej 10,000 lekësh në muaj, për periudhën 1.10.1993 – 1.3.2001, si dhe disa deklarata noteriale të personave të ndryshëm që konfirmonin ekzistencën e kësaj marrëdhënieje qiraje. Subjekti sqaroi se për faktin që nëna e bashkëshortes së tij nuk jeton më, ai e ka të pamundur të paraqesë dokumentacion tjetër lidhur me këto të ardhura. Subjekti sqaroi se as nga Drejtoria Rajonale Tatimore Gjirokastrë nuk kishte marrë dot një informacion lidhur me këtë kontratë qiraje dhe

pagesën e tatimit përkatës pasi kjo zyrë nuk dispononte të dhëna për këtë periudhë, lidhur me këtë marrëdhënie qiraje.

Nga relacioni teknik kontabël i ekspertit të licencuar, kontabël i miratuar, z. F.Q., depozituar nga subjekti në Komision, rezulton se me të ardhurat e tyre nga puna dhe pensionet për periudhat kohore 1.1.1994 – 31.12.2007 dhe 1.1.2008 – 30.6.2014, referuar edhe të dhënave të INSTAT, shtetasit E., dhe S.Z., i kishin mundësitë financiare që të kursenin të ardhura dhe të përballonin shpenzimet për blerjen e apartamentit në vlerën e mbetur (të ardhurat – shpenzimet¹⁸ për periudhën 1.1.1994 – 31.12.2007 janë: 2,793,853 lekë – 2,075, 731 lekë = 718,122 lekë; për periudhën 1.1.2008 – 30.6.2014, janë: 2,595,066 lekë – 1,570,525 lekë = 1,024,541 lekë).

Konkluzion

Në përfundim, Komisioni vlerësoi se pasuria e llojit “apartament”, me adresë në ***, Tiranë, është blerë nga persona të tjerë të lidhur, nga nëna e bashkëshortes së subjektit, por ajo afekton personin e lidhur të subjektit të rivlerësimit, djalin e tij, si përfitues direkt i kësaj pasurie.

Lidhur me të ardhurat që kanë shërbyer për blerjen e kësaj pasurie nga znj. S.Z., nga hetimi rezultoi se shtetasit A., dhe E.L., kanë pasur mundësi financiare nga burime të ligjshme për të krijuar shumën prej 2,500,000 lekësh, dhënë shtetasve S., dhe E.L., në vitin 2000, por mbetet e padokumentuar marrja e shumës dhe përdorimi i saj pikërisht për blerjen e apartamentit në vitin 2008.

Lidhur me të ardhurat nga marrëdhënia e qirasë, Komisioni beson se kjo marrëdhënie qiraje ka ekzistuar, por mbetet i paprovuar pagimi i tatimit mbi të ardhurat nga qiradhënësja S.Z., në kuptim të pikës 3 të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, por nëse do të vlerësojmë të ardhurat e tjera të shtetasve S.Z., dhe bashkëshortit (paga dhe pensione) në raport me shpenzimet e kryera, si dhe pagesat për blerjen e kësaj pasurie, ka rezultuar se ata kanë pasur të ardhura të mjaftueshme për të justifikuar pagesat e kryera edhe nëse të ardhurat nga qiraja nuk do të merren në konsideratë si një burim i ligjshëm.

4. Automjet tip “BMW” i vitit 2006, me targa AA *, blerë me kontratën nr. ***, datë 28.1.2015, me vlerë 6,000 euro. Pjesa takuese: 100 %.**

Burimi i krijimit: Të ardhura nga shitja e automjetit tip “Smart” në datën 24.12.2015.

Në deklaratën “Vetting” subjekti ka deklaruar se për blerjen e automjetit tip “BMW” janë përdorur të ardhurat e përfituara nga shitja e automjetit “Smart” në shumën 6,000 euro.

Në deklaratën periodike të pasurisë të vitit 2015, subjekti ka deklaruar automjet tip “BMW” i vitit 2006 me targë AA ***, në shumën 6,000 euro, shumë e cila zbritet nga shitja e automjetit tip “Smart” (shitur 6,000 euro).

Automjeti tip “BMW” rezultoi se është blerë me kontratën e datën 28.1.2015, ndërsa automjeti tip “Smart” është shitur me kontratën e datës 24.12.2015.

Komisioni i ka kërkuar shpjegime subjektit të rivlerësimit në lidhje me burimin e krijimit të përdorur për blerjen e automjetit tip “BMW”.

¹⁸ Shpenzimeve mesatare mujore për frymë për vitet 1994 - 2014, sipas të dhënave të INSTAT.

Subjekti në përgjigje të tij deklaron: “Burimi i krijimit të shumës 6,000 euro për blerjen e automjetit tip ‘BMW’ me targë AA *** është fillimisht nga gjendja cash që i disponoja në banesë. Në muajin dhjetor, datë 24.12. 2015, pasi kam shitur mjetin Smart me targë AA ***, shumën prej 6,000 euro të konvertuar në kartëmonedhë shqiptare e kam rivendosur përsëri tek cash-i që disponoja në banesë. Në lidhje me sa kam deklaruar kam pasur si qëllimin të sqaroj se bilanci nuk ka ndryshuar, pra, pasi është pakësuar shuma 6,000 euro në muajin janar 2015 nga blerja e automjetit tip ‘BMW’, kjo shumë është plotësuar përsëri në dhjetor 2015 nga shija e automjetit Smart”.

Subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës, ka shpjeguar se në deklaratën “Vetting” ka qenë i pasaktë dhe se burimi i krijimit për blerjen e automjetit tip “BMW” me targa AA *** kanë qenë kursimet cash.

Analiza financiare e vitit 2015

Përshkrimi	2015
Të ardhurat	7,753,355
Nga pagat dhe shpërblimet subjekti	1,636,281
Nga pagat e bashkëshortes	911,208
Të ardhura nga interesat bankare	5,096
Të ardhura nga shitja e mjetit	825,900
Të ardhura nga dhurimi 1	25,130
Të ardhura nga dhurimi 2	4,349,740
Detyrime	0
Shpenzime	1,975,192
Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së	495,855
Shpenzime udhëtimi	41,295
Shpenzime shkollimi	400,000
Shpenzime për shlyerjen e huas R.Z.	825,900
Pasuri	4,911,911
Kursime (pakësim/shtesa likuiditeti)	-288,859
Automjet “BMW”, viti 2006, AA ***	825,900
Truall 168 m ² + banesë private, me sip. 93 m ²	22,850
Objekt me sip. 11.33 m ²	2,280
Apartament A-***, 123.5 m ² , ***	4,349,740
Të ardhura + Detyrime - Shpenzime – Pasuri	866,252

Për sa i përket mundësive financiare për blerjen e automjetit, tip “BMW”, në janar 2015, fillimisht subjekti ka deklaruar si burim krijimi shumën 6,000 euro që rridhte nga shitja e automjetit tip “Smart” në dhjetor 2015 kur duket qartë se ky burim nuk mund të përdorej pasi ishte krijuar më vonë në kohë.

Në pyetësorë subjekti ka deklaruar se burimi i krijimit për blerjen e automjetit tip “BMW” ishte shuma e disponuar *cash*.

Në lidhje me burimin e përdorur për kthimin e huas në vlerën 6,000 euro shtetasit R.Z., sipas deklaratës noteriale nr. ***, datë 24.12.15, subjekti deklaroi vlerën 600,000 lekë kursime në vitin 2015 dhe vlerën 1,800 euro kursime familjare të deklaruara në mënyrë periodike më parë.

Konstatohet se subjekti ka pasur mundësi për të krijuar këto kursime në vitin 2015, si dhe ka pasur kursime të mëparshme të deklaruara.

Për sa i përket burimit të krijimit për blerjen e automjetit tip “BMW” në shumën 6,000 euro, deklaruar si e krijuar nga shitja e automjetit “Smart” në deklaratën “Vetting”, në një kohë kur kjo shumë është krijuar më vonë, subjekti në pyetësorë deklaroi se kjo shumë është disponuar *cash* në banesë, ndërkohë që pas kalimit të barrës së provës deklaroi se burimi është shuma *cash* dhe burimi i krijimit deklaruar në deklaratën “Vetting” është pasaktësi.

Konkluzion

Në përfundim referuar analizës ekonomike të Komisionit rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të kanë pasur të ardhura të mjaftueshme për blerjen e automjetit në përputhje me deklaratimet e bëra prej tij.

Nga hetimi rezultoi se ka pasaktësi në deklarinë në lidhje me burimin financiar të përdorur për blerjen e automjetit tip “BMW”, por që nuk kanë pasur për qëllim fshehje apo deklarim të rremë nga subjekti.

5. Kontratë qiraje e lidhur në datën 1.9.2016 midis O.P., me cilësinë e qiradhënësit dhe K.M., me cilësinë e qiramarrësit, për banesën e ndodhur në lagjen “**”, Gjirakastër, ish-banesa e gjyshërve e trashëguar me testament dhe kontratë dhurimi. Afati i kontratës së qirasë është deri në datën 31.8.2017.**

Qiraja mujore është 250 euro. Të ardhura nga qiraja për periudhën 1.9.2016 – 31.1.2017 janë në vlerën 1,250 euro.

Komisioni ka kryer korrespondencë¹⁹ me Drejtorinë Rajonale Tatimore Gjirakastër e cila konfirmon se O.A.P., është i regjistruar në sistemin tatimor si individ dhe deklaroi dhe paguan tatim burimi për të ardhura të realizuara nga qiraja. Rezulton i paguar tatim burimi për periudhën shtator 2016 – nëntor 2018, në shumën 132,180 lekë, sipas kontratës së qirasë mujore 250 euro.

Subjekti ka depozituar kontratën e qirasë të datës 01.09.2016 lidhur me qiradhënësin O.P., dhe qiramarrësin K.M., me afat qiraje për 1 vit me qira mujore 250 euro/muaj.

Konkluzion

Komisioni, pasi analizoi deklaratimet e subjektit, konstatoi se këto deklarime janë të sakta dhe përputhen me dokumentacionin e vënë në dispozicion nga Drejtoria Rajonale Tatimore Gjirakastër.

¹⁹ Shkresa nr. *** prot., datë 19.12.2018, e Komisionit, drejtuar DR Tatimore Gjirakastër për të dhënat tatimore të subjektit dhe personave të lidhur; shkresa nr. ***prot., datë 28.12.2018, e DR Tatimore Gjirakastër, drejtuar Komisionit, ka vënë në dispozicion të dhëna për punësimin.

6. Detyrim financiar, në shumën 14,000 euro, ndaj shtetasit I.M., me qëllim pagesën e tarifës së shkollimit të djalit të subjektit, O.P.

Subjekti ka sqaruar se për shkak se në atë kohë nuk e dispononte shumën prej 14,000 euro, i ka kërkuar shtetasit I.M., që të paguante nga llogaria e vet në numrin e llogarisë të Universitetit të *** Hollandë, shumën 14,000 euro, për studimet “master” të djalit të subjektit, O.P., veprim i kryer në datën 23 gusht 2016.

Kjo hua është shlyer nëpërmjet llogarisë bankare me burim të ardhura nga kredia dhe të ardhura të tjera familjare.

Subjekti ka marrë një kredi me afat 2 vjeçar në “Societe Generale Albania”, në shumën 1,000,000 lekë, konvertuar në euro sipas kursit ditor të këmbimit datë 22.11.2016 në shumën 7,070 euro, shumë e cila është transferuar nga banka te llogaria e z. I.M.

Shuma prej 240,028.21 lekësh është marrë nga depozita e bashkëshortes + 700,000 lekë (kursime të vitit 2016) + 140,000 lekë nga qiraja e banesës në lagjen “***”.

Detyrim i mbetur ndaj “Societe Generale Albania” deri në datën 9.1.2018 është në shumën 930,972.72 lekë.

Komisioni ka kryer korrespondencë me Qendrën Kombëtare të Biznesit, Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, Drejtorinë Rajonale Tatimore Gjirokastrë, me të gjitha bankat e nivelit të dytë dhe me Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë.

Qendra Kombëtare e Biznesit informon se shtetasi I.M.:

- ka qenë i regjistruar si person fizik që në vitin 1993 sipas vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë për të cilin nuk gjendet NIPT-ti;
- ka qenë ortak dhe administrator i shoqërisë “***” sh.p.k. dhe në datën 5.3.2003 është larguar si ortak dhe administrator i kësaj shoqërie;
- ortak i vetëm dhe administrator në shoqërinë “***” sh.p.k., me NIPT ***;
- ortak me 65% të kuotave dhe administrator i shoqërisë “***” sh.p.k., me NIPT ***;
- ortak me 50% të kuotave në shoqërinë “***” sh.p.k., me NIPT ***.

Komisioni i ka kërkuar subjektit që të provojë me dokumentacion justifikues mundësitë financiare të personit tjetër të lidhur, huadhënësit I.M., për dhënien hua të shumës 14,000 euro.

Subjekti në përgjigje të tij ka deklaruar se z. I.M., është ortak dhe administrator i shoqërisë “***” sh.p.k., me NIPT *** dhe ka bashkangjitur dokumentacionin përkatës (ekstraktin e QKB-së të shoqërisë “***” sh.p.k; nxjerrje llogarie të “Raiffeisen Invest”, të “BKT”-së dhe “Raiffeisen Bank”).

Komisioni i është drejtuar në rrugë elektronike shtetasit I.M., dhe i ka kërkuar të vërtetojë burimin e ligjshëm të shumës 14,000 euro të shoqëruar me dokumentacionin përkatës ligjor që vërteton burimin e të ardhurave, si dhe marrëdhënien e huas me subjektin e rivlerësimit.

Shtetasi I.M., në përgjigjen e tij në rrugë elektronike në datën 13.4.2019, ka deklaruar se z. Arben Pasho e ka njohur që në vitin 1993 kur ka qenë hetues në Gjirokastrë si bashkëqytetar dhe se marrëdhënia e tyre është një marrëdhënie korrekte shoqërore e bazuar në respekt reciprok që përgjatë viteve ka ardhur duke u forcuar. Në muajin gusht 2016 subjekti i kishte kërkuar një ndihmë financiare në shumën 14,000 euro për një pagesë që duhet të bënte urgjent për shkollën e djalit të tij në Holandë.

Pasi ka shpjeguar procedurën e transferimit të shumës monetare për në universitetin ku studionte djali i subjektit në Holandë, shtetasi I.M., sqaron se dhënien e kësaj shume nuk e bëri me noter sepse nuk e vinte në dyshim fjalën e subjektit se do t'ia kthente shpejt detyrimin. Shuma është kthyer në dhjetor 2016 (brenda vitit) nëpërmjet “BKT”-së në numrin e llogarisë të z. I.M., ka dërguar edhe dokumentacion ligjor provues të lëvizjeve bankare (*statement* të llogarisë personale).

Z. I.M., sqaron se burimi i kësaj shume rrjedh nga aktivitetet e tij të ligjshme duke bashkëlidhur edhe dokumentacionin përkatës (ekstraktin e QKB-së për shoqërinë “****” sh.p.k., si dhe nxjerrje llogarish nga bankat e nivelit të dytë, ku ai rezulton me balancë financiare pozitive në vlera të konsiderueshme).

Në analizën financiare të vitit 2016 janë marrë në konsideratë të ardhurat e subjektit dhe bashkëshortes së tij të cilat së bashku me kredinë e marrë në “Societe Generale Albania” kanë shërbyer për të përballuar shpenzimet dhe kthimin e huas.

Përshkrimi	Sipas deklaratave periodike vjetore
Të ardhurat	2,635,755
Nga pagat dhe shpërblimet subjekti	1,549,964
Nga pagat e bashkëshortes	945,359
Të ardhura nga interesat bankare	5,162
Detyrime	1,000,000
Kredi bankare “Societe Generale Albania”	1,000,000
Shpenzime	4,357,958
Shpenzime jetese sipas ILDKPKI së	598,069
Shpenzime udhëtimi	143,386
Shpenzime jetese gjatë shkollimit	1,420,335
Tarifë shkollimi	1,893,780
Shpenzime për shlyerjen e kredisë (principal+interes)	74,364
Shpenzime për rikonstruksionin e shtëpisë	228,023
Pasuri	-229,364
Kursime (pakësim/shtesa likuiditeti)	-229,364
Të ardhura + Detyrime - Shpenzime – Pasuri	-492,839

Duke marrë në analizë deklaratimet periodike vjetore të pasurisë në ILDKPKI, subjekti nuk ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar shpenzimet e kryera gjatë vitit 2016 në shumën - **492,839 lekë**.

Konstatohet mospërputhje deklarimi në lidhje me gjendjen *cash* në 31.12.2014 që ndikon në rezultatin financiar të vitit 2016. Në deklaratën periodike të vitit 2014 nga deklarimi i tij duket se subjekti disponon shumën 3,590 euro dhe 450,000 lekë, në pyetësorë subjekti deklaroi

1,733,530 lekë (12,000 euro), ndërsa në procesverbalin e datës 8.2.2016 të ILDKPKI-së subjekti ka deklaruar se disponon *cash* 12,000 euro dhe 400,000 lekë.

Subjekti, pas dërgimit të rezultateve të hetimit lidhur me analizën financiare të vitit 2016 dhe të gjendjes *cash* për periudhën 31.12.2013 – 31.12.2016, ka deklaruar:

“ Në lidhje me analizën financiare të vitit 2016 që rezulton me balancë negative - 492,839 lekë, në deklarimin periodik të vitit 2016 kam qenë i paqartë në sqarimin e pagesës së shumës 10,500 euro për pagesën e shpenzimeve të jetesës së shkollimit të djalit tim...”

“ Në lidhje me kursimet cash, në deklarimin periodik vjetor të vitit 2014, subjekti deklaroi se ka qenë i pasaktë për blerjen e automjetit tip Smart, i cili ka kushtuar 7,410 euro prej shumës së përgjithshme cash e cila ishte në vitin 2013 në shumën totale 12,000 euro dhe 400,000 lekë shumë të cilën e disponoja cash....në këto rrethana komisioni duhet të bazohet në pyetësorë dhe në sqarimin aktual dhe jo në deklarimet periodike vjetore, kështu që balanca do rezultonte pozitive.”

“Në lidhje me mospërputhjen e deklarimit për gjendjen cash në datën 31.12.2014 (mospërputhje që vërehet në deklaratën periodike të vitit 2014, në pyetësorë dhe në procesverbalin e ILDKPKI-së të datës 8.2.2016), shumës prej 1,483,530 lekësh i kam shtuar kursimet e vitit 2014 të cilat kanë qenë në shumën 250,000 lekë duke shkuar në total shuma 1,733,530 lekë shumë e cila përbënte kursimet cash. Njëkohësisht bashkëshortja ka patur llogari bankare në “BKT” në shumën 298,132 lekë dhe në “Raiffeisen Bank” në shumën 66,592 lekë. Në total gjendja e kursimeve në fund të vitit 2014 është 12,383 euro cash dhe 364,724 lekë në bankë.”

Konkluzion

Komisioni, pasi analizoi dokumentacionin përkatës, deklarimet e subjektit dhe të shtetasit I. M., konkludoi se shtetasi I.M., ka pasur mundësi financiare me burime të ligjshme për të dhënë huan subjektit të rivlerësimit. Kjo hua është transferuar nëpërmjet sistemit bankar nga llogaria e z. I.M., në numrin e llogarisë së universitetit ku studionte djali i subjektit, z. O.P.

Subjekti i rivlerësimit ia ka kthyer këtë hua brenda vitit, z. I.M., nëpërmjet një kredie bankare dhe kursimeve të tjera familjare. Shuma e marrë hua është kthyer nëpërmjet sistemit bankar në llogarinë e z. I.M.

Pasaktësitë në deklarimin periodik të vitit 2014 janë saktësuar dhe deklaruar saktë më vonë në ILDKPKI dhe në pyetësorët e dërguar subjektit të rivlerësimit. Shpjegimet e subjektit përputhen me dokumentacionin e administruar dhe në përfundim rezulton se ai ka pasur të ardhura të mjaftueshme nga burime të ligjshme për kthimin e huas.

❖ **Komisioni hetoi në lidhje me ndonjë situatë të konfliktit të interesit mes subjektit të rivlerësimit dhe shtetasit I.M.,** dhe kreu një korrespondencë me Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, duke kërkuar informacion mbi çështjet penale që mund të ketë pasur ky shtetas (si individ apo si administrator i shoqërive ku ai është ortak) pranë kësaj prokurorie.

Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë ka përcjellë pranë Komisionit tre dosje penale që ka pasur pranë kësaj prokurorie shtetasi I.M.

- i. dosja penale e procedimit nr. *** e vitit 2014 ku ndaj shtetasit I.M., si përfaqësues ligjor i shoqërive “****” sh.p.k., “****” sh.p.k dhe “****” sh.p.k. është hetuar për veprën penale të “pastrimit të produkteve të veprës penale” parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal;
- ii. dosja penale e kallëzimit nr. ***, datë 17.4.2015, ku ndaj shtetasit I.M., për veprën penale të “ndërtimit të paligjshëm”, parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal; dhe
- iii. dosja penale e kallëzimit nr. ***, datë 19.8.2015, ndaj shtetasit I.M., si përfaqësues ligjor i shoqërisë “****” sh.p.k. ndaj veprës penale “shpërdorim i tokës” parashikuar nga neni 199 i Kodit Penal.

Këto procedime penale janë trajtuar te vlerësimi profesional i subjektit të rivlerësimit më poshtë në këtë vendim.

❖ Konstatime të tjera

1. Në deklaratën “Vetting” subjekti ka deklaruar automjet tip “BMW”, viti prodhimit 2000, me targa TR *, blerë me kontratën nr. ***, datë 8.2.2008, vlera 500,000 lekë dhe pjesë takuese 100 % (shitur pa dokumente në shumën 280,000 lekë në vitin 2012).**

Burimi i krijimit: Të ardhura nga kursimet nga paga.

Komisioni ka kryer korrespondencë me DPSHTRR-në, noterin publik Th.K., dhe me Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë.

DPSHTRR-ja ka depozituar dosjen e këtij mjete ku nuk rezulton e depozituar kontrata e shitjes me shitës E.H., dhe blerës Arben Pasho.

Lidhur me këtë fakt subjekti ka sqaruar se mjete është përfshirë dy herë në aksident, në vitet 2008 dhe 2009, duke sjellë dëmtime serioze mekanike, veçanërisht në shasi. *Për këtë shkak mjete i është shitur nga subjekti vëllait të tij çka subjekti e konfirmon me një deklaratë noteriale të datës 16.1.2019 me deklarues vëllain e subjektit, z. A.P., i cili deklaron se në gusht të 2012, vëllai i tij A.P., i ka shitur automjetin tip “BMW”, për çmimin 280,000 lekë.*

Komisioni ka hetuar dhe situatën e konfliktit të interesit në lidhje me shtetasin E.H., familjarët e tij, si dhe ndaj shoqërisë në administrim të familjarëve të tij si: M.H., (i ati), E.H., (i vëllai) dhe shoqërisë “****” sh.p.k., dhe në përfundim nuk rezultoi që subjekti i rivlerësimit të ishte në ndonjë situatë konflikti interesi me personat apo shoqërinë e mësipërme.

Në deklaratën vjetore të pasurisë të vitit 2007, subjekti deklaroi shtesë pasurie për blerjen e një automjeti tip “BMW”, i vitit 2000, me targa TR ***, blerë me kontratën nr. ***, datë 8.2.2008, në vlerën 500,000 lekë.

Në analizën financiare kjo pasuri analizohet në vitin 2008, vit në të cilin ka dhënë edhe efektet financiare, pavarësisht vitit të deklarimit.

Komisioni, pasi analizoi dokumentacionin dhe deklaratimet e subjektit, konkludoi se subjekti nuk e ka bërë ndryshimin e pronësisë së këtij mjete sipas parashikimeve të dispozitave të Kodit Rrugor.

Në lidhje me burimin e krijimit të kësaj pasurie subjekti ka deklaruar si burim kursimet nga pagat, por nga verifikimi i deklaratimeve të tij në lidhje me likuiditetin për vitin 2007 rezultoi që ai nuk ka patur kursime *cash* për të blerë automjetin tip “BMW”, si dhe nuk rezultoi të jetë bërë ndonjë tërheqje nga llogaritë bankare për periudhën 1.1.2008 – 8.2.2008.

Në lidhje me mosdeklarimin e shumë *cash* për vitin 2007, subjekti deklaroi se ka qenë pasaktësi nga ana e tij dhe pikërisht kjo shumë ka shërbyer si burim për blerjen e automjetit tip BMW (me targa TR ***), në shkurt të vitit 2008, dhe se kjo shumë ka si burim të ardhurat nga pagat e vitit 2007.

Konkluzion

Në përfundim Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë i saktë në deklarimin periodik të vitit 2007 dhe atë të vitit 2008 lidhur me deklarimin e gjendjes *cash* dhe blerjen e automjetit. Subjekti ka deklaruar se ka blerë automjetin në vitin 2007 duke deklaruar edhe shpenzimet në shumën prej 500,000 lekësh, por që në fakt gjatë hetimit rezultoi se është paguar në datën 8 shkurt 2008.

Komisioni nuk konstatoi ndonjë situatë të konfliktit të interesit ndërmjet subjektit të rivlerësimit dhe shtetasve E.H., familjarëve të tij, si dhe ndaj shoqërisë në administrim të familjarëve të tij, si M.H., (i ati), E.H., (i vëllai) dhe shoqërisë “***” sh.p.k.

2. Apartament me sip. 76 m², në Vlorë, në bashkëpronësi

Nga korrespondenca me ZVRPP-në Vlorë dhe me noteren M.Gj., konfirmohet pasuria e paluajtshme e llojit apartament, me sip. 76 m², e ndodhur në z.k. ***, Vlorë, e regjistruar në pronësi të shtetasve Ç.P., Arben Pasho, M.P., dhe A.P., pasuri e cila në datën 7.6.2017 ka kaluar në pronësi të shtetasve A., dhe L.P., me kontratë dhurimi.

Ky apartament është përfituar nga kontrata e privatizimit në datën 21.6.1993 e lidhur ndërmjet Ndërmarrje Komunale Banesa Vlorë dhe qiramarrësit Ç.P., për vlerën 14,360 lekë. Bashkëpronarë në këtë banesë janë edhe A.P., A.P., A.P., A.P., A.P., L.P., dhe M.P.

Me dëshminë e trashëgimisë ligjore të datës 11.5.2017 (pasi Ç.P., ka ndërruar jetë në datën 30.4.2001) përcaktohen si trashëgimtarë të radhës së parë A.P., (bashkëshortja), A.P., (i biri), A.P., (i biri), Arben Pasho (i biri) dhe A.Ç., (e bija), të cilët përfitojnë 1/5 pjesë të të drejtave dhe detyrimeve që rëndojnë mbi pasurinë trashëgimore të trashëgimlënësit.

Me kontratën e dhurimit të datës 30.5.2017, me palë dhuruese A.P., (e ëma e Arben Pasho), A.P., (vëllai), Arben Pasho, A.Ç., (e motra), dhe M.P., (këta të fundit përfaqësuar me prokurë nga L.P.) i dhurojnë pjesën takuese në apartamentin me sip. 76 m², z.k. ***, vol. ***, q. ***, Vlorë, pranuesit të dhurimit A.P..

Komisioni ka konstatuar se pjesa takuese e bashkëpronësisë së apartamentit në Vlorë nuk është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, në deklaratat e pasurisë të viteve 2003 - 2016 dhe në deklaratën “Vetting”.

Subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës nga Komisioni, ka deklaruar: “ *Në vitin 1993 kur është lidhur kontrata e privatizimit të banesës nga babai Ç.P., nuk kam pasur dijeni për veprimet konkrete pasi jam larguar nga qyteti i Vlorës që nga viti 1986 dhe prej kësaj periudhe nuk jam rikthyer në Vlorë dhe nuk kam banuar aty. Në datën 23.1.1993 jam ndarë nga trangu familjar dhe bashkëpronësinë në këtë apartament e kam mësuar në muajin maj 2017, ku familjarët më kanë informuar se do të aplikojnë për certifikatë pronësie dhe se unë me bashkëshorten time ishin bashkëpronarë.*”

Subjekti deklaron se nuk ka qenë pjesë në asnjë veprim të kryer për privatizimin e banesës dhe se nuk ka pretenduar asnjëherë pjesë në këtë pasuri, pasi ka vlerësuar se ajo i përket vëllait i cili ka jetuar aty me prindërit.

Konkluzion

Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar pjesën e tij dhe të bashkëshortes në bashkëpronësi në apartamentin e ndodhur në qytetin e Vlorës (në deklaratat e pasurisë për vitet 2003 – 2016 si dhe në deklaratën “Vetting”). Mosdeklarimi i kësaj pasurie nuk rezultoi të jetë i qëllimshëm. Nga hetimi rezultoi se ata e kanë dhuruar pjesën e tyre në bashkëpronësi familjarëve të cilët realisht kanë banuar në atë pronë, pa kundërshtpërblim.

3. Llogari bankare në “BKT” në emër të znj. M.P., bashkëshortja e subjektit

“ BKT”-ja ka konfirmuar se në datën 25.2.2008 është kryer veprimi bankar – depozitim *cash* – në vlerën 3,500,000 lekë nga znj. M.E.P., shumë e cila është konvertuar në monedhën dollarë amerikan për vlerën 41,822.51 USD. Përfituesi i kësaj transferte rezulton të jetë z. A.L., me banim në SHBA.

Në shpjegimet dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion nga subjekti i rivlerësimit del e qartë se shtetasja M.P., ka vepruar në emër dhe për llogari të shtetasve A., dhe E.L., të cilën jetojnë në SHBA, duke nënshkruar një deklaratë noteriale²⁰ me shtetasin V.N., ku pasqyrohet fakti se ky shtetas i dorëzon znj. M.P., shumën prej 3,800,000 lekësh dhe merr në dorëzim apartamentin në pronësi të shtetasit A.L.

Në datën 30.6.2011 është hartuar kontrata e shitblerjes²¹, nëpërmjet të cilës shtetasi A.L., i shet shtetasit V.N., një apartament banimi me sip. 75.8 m², me çmim **3,641,053 lekë**, ndodhur në Gjirokastrë.

Referuar kartelës së pasurisë së paluajtshme, pasuria në datën 27.9.2011 figuron në emër të blerësit, shtetasit V.P.N.

Subjekti ka bashkangjitur dokumentacionin e pronësisë së apartamentit me sip.75.8 m², me adresë: Lagjja “***”, Gjirokastrë, në emër të z. A.L., dhe transaksionet e kryera ndër vite për këtë pasuri.

Konstatohet se me kontratën e shitblerjes së datës 30.6.2011 është realizuar shitja e apartamentit të mësipërm, me shitës A.L., dhe blerës V.N., kundrejt çmimit 3,800,000 lekë. Në vitin 2008 shtetasi V.N., ka marrë në dorëzim banesën e shtetasit A.L., dhe pagesën ia ka bërë zj. M.P., e cila më pas këtë shumë ia transferoi në SHBA me llogari bankare A.L.

Konkluzion

Komisioni vlerësoi shpjegimet e subjektit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion nga ai dhe institucionet duke i konsideruar ato të qarta, bindëse dhe në përputhje me dokumentet e administruara.

Nga dokumentacioni u konstatua se znj. M.P., ka vepruar në emër dhe për llogari të shtetasit A.L., dhe se kjo pasuri nuk lidhet me subjektin e rivlerësimit, por është pasuri ekskluzive e shtetasit A.L.

²⁰ Deklarata noteriale nr. ***, datë 25.2.2008.

²¹ Kontrata nr. ***, datë 30.6.2011.

Konkluzione përfundimtare për vlerësimin e kriterit të pasurisë.

Në lidhje me vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, që rezultoi në disa pasaktësi në deklaram dhe një mosdeklaram të pjesës takuese në një pasuri të paluajtshme, trupi gjykues, mbështetur në parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit arrin në përfundimin se këto problematika nuk përbëjnë shkak të mjaftueshëm dhe nuk arrijnë deri në atë nivel që të përmbushin aplikimin e pikave 1 dhe 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Në vlerësimin e tij Komisioni mban parasysh edhe faktin se subjekti i rivlerësimit ka treguar gatishmërinë e tij të menjëhershme për të dhënë sqarime rreth fakteve të rezultuara nga hetimi, kur është pyetur nga Komisioni, po ashtu edhe gjatë seancës dëgjimore duke krijuar bindjen se ai ishte i vërtetë në deklaramet e tij.

B. KONTROLLI I FIGURËS

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka dërguar në Komision raportin mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit z. A.Ç.P., i deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. ***, datë 24.4.2019, të KDZH-së.

Për subjektin e rivlerësimit, z. A.Ç.P., nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar.

Në përfundim të raportit, Grupi i Punës konstaton përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. A.Ç.P.

Komisioni, gjatë hetimit lidhur me ndonjë situatë të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit dhe shtetasit I.M., ka administruar dosjen penale të procedimit nr. ***, viti 2014, ku ndaj shtetasit I.M., si përfaqësues ligjor i shoqërive “****” sh.p.k., “****” sh.p.k., dhe “****” sh.p.k., është bërë hetimi për veprën penale “pastrim i produkteve të veprës penale”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal. Nga verifikimi i dokumentacionit në dosje, kjo çështje është hetuar nga prokurori P. D.

Komisioni, referuar natyrës së procedimit penal, dhe në zbatim të pikës 15, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, ku përcaktohet: *“15. Person i përfshirë në krimin e organizuar, është çdo person që është dënuar apo proceduar penalisht brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për një nga veprat e parashikuara në pikën 1, të nenit 3, të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009 ‘Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar...’, me përjashtim të rastit kur është deklaruar i pafajshëm me vendim gjyqësor të formës së prerë. Personi konsiderohet i përfshirë në krimin e organizuar edhe kur: a) procedimi penal i filluar ndaj tij pushohet nga organi procedues për shkak të vdekjes, ose sepse nuk mund të merret si i pandehur dhe nuk mund të dënohet; b) deklarohet i pafajshëm nga gjykata...”*, ngriti dyshimin për mundësinë e një kontakti të papërshtatshëm të subjektit të rivlerësimit dhe mosdeklaramin e tij në deklaramtën e kontrollit të figurës së subjektit në përputhje me nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës.

Nga verifikimi i deklaramtës për kontrollin e figurës, në pikën 5, te rubrika “të dhëna për sigurinë”, subjekti i rivlerësimit, z. Arben Pasho, nuk ka deklaruar asnjë lloj komunikimi apo marrëdhënie me një, ose më shumë kontakte të papërshtatshme.

Bazuar në: (i) deklaratimet e shtetasit I.M., për njohjen dhe miqësinë e tij të hershme me subjektin e rivlerësimit (që në vitin 1993, miqësi që ka ardhur duke u forcuar); (ii) informacionin mbi procedimin penal nr. *** të vitit 2014, ku ndaj shtetasit I.M., si përfaqësues ligjor i shoqërive “****” sh.p.k., “****” sh.p.k. dhe “****” sh.p.k., është hetuar për veprën penale “pastrim i produkteve të veprës penale”; dhe (iii) detyrimin sipas pikës 4, të nenit Dh, të Aneksit të Kushtetutës, i cili parashikon se nëse subjekti i rivlerësimit përpjetet të bëjë deklaratime të pasakta, ose të fshehtë kontaktet me persona të përfshirë në krimin e organizuar, zbatohet prezumimi në favor të masës disiplinore të shkarkimit, ku subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, lidhur me mosdeklarimin në formularin e kontrollit të figurës të shtetasit I.M., si një kontakt i papërshtatshëm.

Subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës nga Komisioni në lidhje me konstatimin e mësipërm, ka shpjeguar: *“...në lidhje me dosjen e këtij procedimi, aktet i ka administruar prokurori P. D., i cili mbi bazën e tyre në konsultim me subjektin në cilësinë e drejtuesit ka vendosur regjistrimin e çështjes penale. Në këndvështrim të nenit 287 të Kodit të Procedurës Penale ... emri i personit që i atribuohet vepra penale shënohet në të njëjtën kohë me regjistrimin e veprës penale, ose dhe më vonë.... duke qenë se prokurori ka çmuar se nuk ka pasur të dhëna të mjaftueshme, nuk ka regjistruar emër personi që i atribuohet vepra penale.... Gjatë fazës së hetimit paraprak në analizë të provave, prokurori i çështjes nuk i ka dhënë shtetasit I.M., as cilësinë e personit nën hetim, apo dhe të pandehurit, çka do të nënkuptonte se do të fillonin të ecnin afatet e hetimit sipas përcaktimeve të nenit 323 - 325 të Kodit të Procedurës Penale.*

*...pas analizës së provave, prokurori, në datën 30.12.2014, ka vendosur të pushojë hetimet e çështjes penale nr. *** të vitit 2014 për arsye se faktet e relatuar dhe të hetuara, nuk përbëjnë vepër penale.”*

Referuar pikës 15, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, shtetasi I.M., nuk është i dënuar dhe as i proceduar penalisht për veprën penale të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, pasi ky person nuk ka marrë cilësinë e personit nën hetim dhe nuk është marrë si i pandehur. Subjekti i rivlerësimit paraqiti si provë fletën e regjistrimit të veprave penale, nga e cila rezultoi se emri i shtetasit I.M., nuk është regjistruar si person nën hetim, megjithëse vepra e regjistruar i atribuohet atij si përfaqësues ligjor i shoqërive “****” sh.p.k., “****” sh.p.k., dhe “****” sh.p.k.

Fakti i mosregjistrimit të shtetasit I.M., në regjistrin e veprave penale në cilësinë e personit të proceduar penalisht, nuk e bën atë formalisht një kontakt të papërshtatshëm për subjektin e rivlerësimit, duke përjashtuar kështu detyrimin e subjektit për ta deklaruar si kontakt të papërshtatshëm në deklaratën e kontrollit të figurës.

Konkluzione përfundimtare për vlerësimin e kriterit të figurës

Në përfundim, trupi gjykues vlerësoi se subjekti i rivlerësimit, z. Arben Pasho, ka plotësuar në mënyrë korrekte deklaratën për kontrollin e figurës, pasi pavarësisht dënjësive së tij lidhur me procedimin penal nr. *** të vitit 2014, për veprën “pastrim i produkteve të veprës penale”, formalisht, emri i shtetasit I. M., nuk figuron si person i regjistruar në regjistrin e veprave penale si autor i veprës penale dhe, për pasojë, ai nuk mund të konsiderohet si kontakt i papërshtatshëm në kuptim të pikës 1, të nenit 3, të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009, *“Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar...”*.

Për subjektin e rivlerësimit, z. Arben Pasho, Komisioni nuk pati asnjë të dhënë mbi veprimtarinë korruptive, apo mbi kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar. Në vlerësim të provave të administruara, trupi gjykues krijoi bindjen se subjekti i rivlerësimit nuk ka cenuar asnjë nga parimet e parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës, apo të pikave 2 dhe 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

Rivlerësimi profesional sipas nenit 44, të ligjit nr. 84/2016, është i bazuar në raportin e Grupit të Punës të Prokurorisë së Përgjithshme si organi ndihmës për vlerësimin profesional, që kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit, bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i cili ka hartuar raportin vlerësues nr. *** prot., datë 16.4.2018, për subjektin e rivlerësimit, z. Arben Pasho.

Në raportin e Grupit të Punës së Prokurorisë së Përgjithshme janë evidentuar aftësi të mira të subjektit të rivlerësimit në lidhje me:

- ✓ aftësitë organizative;
- ✓ etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale;
- ✓ aftësitë personale dhe angazhimi profesional.

Në tri dokumentet e paraqitur nga vetë subjekti, Komisioni nuk konstatoi veprime të subjektit në shkelje me ligjin apo procedurën.

Në pesë dosjet e shortuara nga Komisioni, në tri prej tyre nuk janë konstatuar problematika, ndërsa në dy dosjet e para janë konstatuar problematikat, si më poshtë vijon:

Dosja nr. 1 – në këtë dosje është regjistruar kallëzimi penal nr. ***, datë 12.12.2013, për të cilën është vendosur mosfillimi i procedimit penal (materiali kallëzues) në datën 27.12.2013, në bazë të kallëzimit penal të depozituar nga shtetasja H. B., për veprat penale “pushtimi i tokës” dhe “kanosje”, parashikuar nga nenet 200 dhe 84 të Kodit Penal.

Komisioni, pas verifikimit të dokumentacionit të këtij procedimi, ka konstatuar se:

- në vendimin “për mosfillimin e procedimit penal”, datë 27.12.2013, të marrë nga subjekti, në brendësi të tij nuk gjendet i pasqyruar fakti i veprës penale “kanosje”;
- akti i njoftimit të vendimit të mosfillimit të procedimit penal nuk ka datë se kur është njoftuar;
- akti i njoftimit të vendimit të pushimit tek emri “prokurori i rrethit Arben Pasho”, duket se nuk është nënshkruar nga vetë subjekti Arben Pasho, por te nënshkrimi ka një gërmë P/, që do të thotë se ky akt është nënshkruar nga një person i autorizuar për të cilin nuk u gjet ndonjë akt delegimi.

Subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës, ka deklaruar: “...veprimi i kanosjes ishte verbal dhe nuk kishte prova reale për t’u diskutuar. Ishte debat mes palëve pa dëshmitarë të pranishëm... dhe në këto rrethana kam çmuar se nuk kishte elementë të veprës penale të kanosjes.

...

Njoftimi është bërë sipas ligjit... por për shkak neglizhence apo të ngarkesës në punë nga sekretaria nuk është vendosur data e njoftimit.”

Në lidhje me “nënshkrimin” subjekti nuk dha shpjegime.

Referuar dokumentacionit në dosjen penale, si dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti, Komisioni konstaton se mangësitë procedurale i referohen neglizhencës së sekretarisë së prokurorisë.

Dosja nr. 2 – në këtë dosje është regjistruar procedimi penal nr. ***, datë 22.10.2013, për të cilën është vendosur pushimi i procedimit penal në datën 17.4.2014. Në datën 22.10.2013 është vendosur regjistrimi i çështjes penale në ngarkim të shtetasit A.H., për veprën penale “organizimi i llotarive të palejuara”, të parashikuar nga neni 197 i Kodit Penal.

Komisioni, pas verifikimit të dokumentacionit të këtij procedimi, ka konstatuar se:

- hetimet për këtë vepër penale janë zgjatur më shumë se afati i parashikuar nga ligji, pasi vepra penale është referuar në prokurori në datën 18.10.2013 dhe vendimi i pushimit të procedimit penal është marrë në datën 17.4.2014, dhe në dosje mungon vendimi për zgjatjen e afateve të hetimit nga ana juaj si prokuror i çështjes;
- në vendimin e pushimit nuk evidentohet fakti që personi ndaj të cilit janë zhvilluar hetime ka ndryshuar dëshminë e tij gjatë pyetjes nga Oficeri i Policisë Gjyqësore, referuar procesverbalit të datës 19.12.2013;
- akti i njoftimit të vendimit të pushimit të hetimeve i është njoftuar palëve në datën 19.3.2015, tej afatit të përcaktuar ligjor.

Subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës nga Komisioni, ka shpjeguar: “... në procesverbalin e pyetjes së shtetasit A. H., të datës 16.10.2013, përpiluar nga OPGJ-ja, A. R., nuk del qartë nëse personi kërkonte ose jo mbrojtës, pasi në procesverbal nuk pasqyrohej një gjë e tillë dhe procesverbali kishte mangësi të theksuara prandaj dhe e kam çmuar aktin e pavlefshëm dhe kam lënë urdhër që ky person të pyetjet në cilësinë e personit nën hetim.

....

Në lidhje me njoftimin tej afatit, kjo ka ndodhur për shkak të ngarkesës dhe pakujdesisë së sekretarisë së prokurorisë...”

Referuar dokumentacionit në dosjen penale, si dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti, Komisioni konstaton se dosja ka disa mangësi procedurale për të cilat subjekti i rivlerësimit duhet të kishte treguar kujdes pavarësisht shpjegimeve të tij për neglizhencë të sekretarisë së prokurorisë.

TË DHËNAT ARKIVORE (ankesat dhe masat disiplinore – vlerësimet)

Nga verifikimi në arkivën e Prokurorisë së Përgjithshme nuk rezulton që subjekti Arben Pasho të ketë pasur masa disiplinore.

Në emër të subjektit të rivlerësimit, z. Arben Pasho, ka rezultuar se janë depozituar pesë ankesa, të cilat janë trajtuar nga Prokuroria e Përgjithshme dhe, në përfundim, nuk janë konstatuar elementë të cilët përbëjnë shkelje disiplinore nga subjekti.

DENONCIMET NGA PUBLIKU

Ndaj subjektit të rivlerësimit, z. Arben Pasho, janë depozituar 14 denoncime nga publiku. Në 11 denoncime të analizuara, Komisioni nuk konstatoi problematika në lidhje me subjektin e rivlerësimit, z. Arben Pasho. Ndërsa, referuar tri denoncimeve të tjera, Komisioni konstatoi problematikën, si vijon:

➤ **Denoncimi nr. *** prot., datë 11.9.2018, i shtetasit K.Ll.**

Z. K.Ll., në lidhje me procedimin penal nr. *** të vitit 2017, me kallëzues të atin e tij, z. Q. Ll., ka ngritur pretendimin se dosja që është marrë në hetim nga z. Arben Pasho, megjithëse kanë kaluar 9 muaj, nuk është dërguar ende në gjykatë.

Komisioni ka kryer korrespondencë²² me Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, e cila ka vënë në dispozicion dosjen e procedimit penal nr. ***, datë 13.9.2017, e cila i referohet kallëzimit të datës 13.9.2017, për veprën penale të falsifikimit, të bërë nga shtetasi Q.Ll.

Konkluzion

✓ Komisioni konstatoi se kjo çështje vijon ende të jetë nën hetim nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë.

✓

➤ **Denoncimi nr. *** prot., datë 8.2.2018, i shtetasit A.S.**

Shtetasi A.S., ngre ankesë ndaj subjekteve M. I., I. S., J. Ç. dhe subjektit Arben Pasho, ndaj të cilit pretendon se ka zvarritje të çështjes hetimore deri në 4 vjet, duke mbrojtur hapur falsifikimin dhe përdorimin e dokumenteve të falsifikuara.

Komisioni, pas analizimit të dokumentacionit në dosjen penale, konstatoi se:

- Subjekti, me cilësinë e drejtuesit të prokurorisë, ka mbajtur dy qëndrime të ndryshme në dy ditë të ndryshme, pasi në datën 12.12.2011, kallëzuesit i është komunikuar vendimi i pushimit të datës 2.12.2011 (marrë nga prokurori i çështjes S. Ç.) i procedimit penal nr. ***, i vitit 2011, ndërkohë që në datën 13.12.2011, nga subjekti, me cilësinë e drejtuesit, është marrë vendimi i shfuqizimit të vendimit të pushimit të datës 2.12.2011 të procedimit penal nr. ***, të vitit 2011.
- Në dosjen penale mungon vendimi, i drejtuesit të prokurorisë i cili konfirmon vendimin e pushimit të datës 17.1.2013, të procedimit penal nr. ***, i vitit 2011, të marrë nga prokurori i çështjes S. Ç.
- Në dosjen penale mungon urdhri/vendimi si drejtues prokurorie për zëvendësimin e prokurorit S. Ç. me prokurorin J. Ç. në të njëjtën çështje, në përputhje me nenin 27 të Kodit të Procedurës Penale.
- Në cilësinë e drejtuesit të prokurorisë, subjekti nuk është thelluar për sa i përket hetimeve të kësaj çështjeje, pasi janë miratuar dy herë dy vendimet e pushimit të procedimit, atij të datës 17.1.2013 dhe të datës 7.9.2015, vendime këto të dy të prishura nga gjykata për hetime të mëtejshme që duhen bërë prokuroria.

²² Shkresa nr. *** prot., datë 4.3.2019, drejtuar Prokurorisë Sarandë; shkresa nr. ***prot., datë 11.3.2019, drejtuar Komisionit; shkresa nr. *** prot., datë 18.3.2019, drejtuar Gjykatës së Rrethit Sarandë; shkresa nr. *** prot., datë 21.3.2019 drejtuar Komisionit.

Subjekti i rivlerësimit, pas kalimi të barrës së provës nga Komisioni, ka dhënë shpjegime si vijon:

Në lidhje me dy vendimet e ndryshme për të njëjtin procedim subjekti ka dhënë shpjegime: *“...me vendimin e datës 2.12.2011 është vendosur pushimi i çështjes nga prokurori S. Ç. Nga verifikimi që i kam bërë vendimit të pushimit të hetimeve dhe veprimeve të kryera fillimisht e kam konsideruar të drejtë... vendimi i pushimit u është njoftuar shtetasve Sh. H. dhe A. S., të cilët, më datë 12.12.2011. Shtetasi A. S., është paraqitur në zyrën time dhe ka kundërshtuar vendimin e pushimit verbalisht duke pretenduar se nuk ishin kryer hetime të plota. Për të pasur një qëndrim sa më objektiv të çështjes kam vendosur ta shfuqizoj vendimin e pushimit... në fakt pretendimet mbi bazën e të cilave kam bërë shfuqizimin nuk i kam administruar me shkrim, por i kam çmuar me objektivitet.”*

...

Në lidhje me mungesën e vendimit të zëvendësimit të prokurorit S. Ç. me J. Ç. subjekti ka shpjeguar: *“...kam vendosur zëvendësimin e prokurorit S. Ç. me qëllim mosparagjykimin e zgjidhjes që do rezultonte për çështjen... Mungesa e aktit të zëvendësimit të prokurorit nuk ka sjellë pasojë në çështjen penale dhe prokurori S. Ç. ka dhënë pëlqimin verbal për zëvendësimin...”*

Për sa i përket faktit të mosthëllimit në hetime, pasi në dy raste gjykata ka kërkuar vijimin e hetimeve, subjekti ka shpjeguar: *“...qëndrimi ynë në lidhje me këtë çështje, ka qenë objektiv dhe veprimet e kryera pas shfuqizimeve vetëm sa kanë konfirmuar faktin se nuk ka vepër penale...”*

Komisioni, pas analizimit të dokumentacionit në dosje dhe shpjegimeve të subjektit, konkludon se veprimet e subjektit të rivlerësimit, në nxjerrjen e dy vendimeve, konkretisht vendimi i pushimit të procedimit penal nr. ***, datë 2.12.2011, dhe vendimi që shfuqizon vendimin e mësipërm të pushimit të prokurorit, janë marrë pa kryer një analizë të thelluar profesionale që do të justifikonte këtë vendimmarrje, dhe në mënyrë impulsive, çka nuk përkon me etikën e tij si prokuror.

Zëvendësimi i prokurorëve në këtë procedim penal është bërë në mënyrë verbale, dhe i pamaterializuar me një dokument ligjor sipas përcaktimeve të nenit 27, të Kodit të Procedurës Penale, çka nuk garanton të drejtat e palëve.

➤ **Denocimi nr. *** prot., datë 15.3.2019, i shtetasës L.P.**

Shtetasja L.P., është ankuar ndaj subjektit të rivlerësimit, z. Arben Pasho, me pretendimin se ka pushuar çështjen e saj padrejtësisht dhe nuk ka studiuar dosjen. Gjithashtu, ky prokuror ka vendosur pushimin e çështjes penale ndërkohë që vjen fletëthirrja nga gjykata se çështja ishte dërguar për gjykim nga prokurori. Denoncuesja, në denoncimin e saj, vijon se kur u paraqit në gjykim, prokurori deklaroi para gjykatës se është bërë gabim nga kancelaria, gjë që nuk është e vërtetë.

Nga korrespondenca²³ e kryer me Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, si dhe Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, janë vënë në dispozicion të Komisionit dosjet penale respektive të çështjes penale nr. ***, të vitit 2017.

Komisioni, pas analizimit të dokumentacionit në dosjen penale, konstatoi se:

- Subjekti, në cilësinë e prokurorit të çështjes, nuk ka respektuar afatin 5-ditor të njoftimit të vendimit të pushimit, sipas parashikimeve të nenit 328, të Kodit të Procedurës Penale. Pra, vendimi i pushimit është marrë në datën 15.7.2018, ndërkohë që, referuar akteve në dosje, rezulton se vendimi i pushimit u është komunikuar palëve me shkresën nr. *** prot., datë 7.1.2019, pra, rreth 4 muaj me vonesë.
- Subjekti, në cilësinë e prokurorit të çështjes, ka vepruar në mënyrë të gabuar dhe në kundërshtim me nenin 328 të Kodit të Procedurës Penale, për sa i përket procedurës së pushimit të çështjes penale, pasi ky nen parashikon: *“Në përfundim të hetimeve paraprahe, kur procedohet për kundërvajtje penale, prokurori vendos pushimin e akuzës ose çështjes dhe brenda 5 ditëve ia komunikon palëve në mënyrë që të marrin kopje të tij dhe për të paraqitur ankim në gjykatë”*.

Subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës, ka shpjeguar: *“...kam përpiluar vendimin e pushimit të çështjes dhe dosja është dorëzuar në sekretari për të bërë njoftimet sipas ligjit. Për shkak të ngarkesës sekretaria nuk i ka bërë njoftimet në kohë, por njëkohësisht gabimisht e ka përcjellë dosjen në gjykatë me idenë se çështja duhej të pushohej nga gjykata. Kancelaria e gjykatës e ka hedhur në short dhe unë jam thirrur në seancë gjyqësore dhe jam paraqitur në seancë me idenë se çështja ishte vënë në lëvizje nga shtetasja L.P ...”*

Komisioni, referuar dokumentacionit në dosjen penale, si dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti, konstaton se dosja ka disa mangësi procedurale, për të cilat subjekti i rivlerësimit duhet të kishte treguar kujdes duke kryer verifikimet përkatëse, pavarësisht shpjegimeve të tij se ato i referohen neglizhencës së sekretarisë së prokurorisë.

Subjekti, në cilësinë e drejtuesit të prokurorisë, nuk rezultoi të ketë ndërmarrë ndonjë veprim parandalues apo masë disiplinore në ngarkim të punonjësve të sekretarisë së prokurorisë për shkelje të ndryshme administrativo-ligjore (njoftimi i vendimit palëve me vonesë, përcjellja gabimisht e dosjes në gjykatë, etj.).

Dosjet e procedimeve penale ndaj shtetasit I.M., të kërkuara për vlerësim, lidhur me situatën e konfliktit të interesit

Referuar faktit se gjatë hetimit ka rezultuar se shtetasi I.M., dhe subjekti i rivlerësimit, z. Arben Pasho, kanë njohje të hershme mes tyre dhe marrëdhënie miqësore, e provuar kjo edhe me faktin e marrëdhënies së huas në vitin 2016 nga shtetasi I. M. Për subjektin e rivlerësimit (të shpjeguar më lart), Komisioni ka vendosur të hetojë lidhur me raste të mundshme të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit me shtetasin I. M.

Nga korrespondenca me Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë janë vënë në dispozicion kopje të dosjeve penale që shtetasi I.M., ka pasur në këtë prokurori, nga ku ka rezultuar:

²³ Shkresa nr. *** prot., datë 29.3.2019, e Prokurorisë Gjirokastrë, drejtuar Komisionit, si dhe dosja përkatëse bashkëngjitur saj; shkresa nr. *** prot., datë 8.4.2019, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë.

1. Dosja penale e procedimit nr. *** e vitit 2014, ku ndaj shtetasit I.M., si përfaqësues ligjor i shoqërive “***” sh.p.k., “***” sh.p.k. dhe “***” sh.p.k., është hetuar për veprën penale “pastrimi i produkteve të veprës penale”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, ku kjo prokurori në datën 30.12.2014 ka vendosur: “Pushimin e procedimit penal nr. *** të vitit 2014” në ngarkim të shtetasit I.M. Kjo çështje është hetuar nga prokurori P. D.

Subjekti Arben Pasho, në cilësinë e drejtuesit të prokurorisë, ka miratuar këtë vendim duke ia njoftuar palëve të interesuara.

2. Dosja penale e kallëzimit nr. ***, datës 17.4.2015, ndaj shtetasit I.M., hetuar për veprën penale “ndërtim i paligjshëm” parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal. Nga kjo prokurori, në datën 25.5.2015, është vendosur: “Mosfillimi i procedimit penal”. Kjo çështje është hetuar nga prokurori Gj. F. Subjekti Arben Pasho, në cilësinë e drejtuesit të prokurorisë, ka miratuar këtë vendim duke ia njoftuar palëve të interesuara.

3. Dosja penale e kallëzimit nr. ***, datë 19.8.2015, ndaj shtetasit I.M., si përfaqësues ligjor i shoqërisë “***” sh.p.k., hetuar ndaj veprës penale “shpërdorim i tokës” parashikuar nga neni 199 i Kodit Penal.

Kjo çështje është hetuar nga subjekti i rivlerësimit, z. Arben Pasho, njëkohësisht edhe drejtuesi i prokurorisë.

Kjo prokurori, në datën 24.8.2015, ka vendosur: “Mosfillimin e procedimit penal”.

Komisioni, referuar faktit se nga shtetasi I.M., është deklaruar njohja 26-vjeçare me subjektin e rivlerësimit, pasuar kjo nga fakti i dhënies hua subjektit të shumës prej 14,000 euro, deklarimit nga subjekti të një udhëtimi të djalit të tij me ftesë të shtetasit I.M., në Francë në vitin 2016, me automjetin e këtij të fundit, krijon bindjen se subjekti ka lidhje shoqërore dhe interesi me shtetasin I.M.

Në vlerësim të pikës “ç”, të nenit 3, të ligjit nr. 8737, datë 12.2.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” parashikohet se:

“1. Drejtuesit të prokurorisë së rrethit gjyqësor..., kur gjendet në një çështje penale në rastet e parashikuara në nenet 16 e 17, pika 1, të Kodit të Procedurës Penale, i ndalohet t’i japë urdhra dhe udhëzime, me shkrim, prokurorit të çështjes apo të ndikojë në çdo mënyrë tjetër.

2. Në këtë rast, drejtuesi në konflikt interesi njofton, me shkrim, Prokurorin e Përgjithshëm. Prokurori i Përgjithshëm, kryesisht ose me kërkesë, vendos me shkrim për përjashtimin e drejtuesit në konflikt interesi nga procedura e dhënies së urdhrave dhe udhëzimeve. Në këtë vendim, Prokurori i Përgjithshëm cakton nëse dhe në ç’pjesë kanë vlerë veprimet e kryera në bazë të urdhrave dhe udhëzimeve të dhëna më parë nga drejtuesi në konflikt interesi.

3. Në rastin kur Prokurorit të Përgjithshëm i kërkohet nxjerrja e një urdhri apo dhënia e një udhëzimi në një procedim, në të cilin ai është në konflikt interesi, atëherë ai deklaron, me shkrim, gjendjen e konfliktit të interesit dhe njofton prokurorin, që i ka kërkuar nxjerrjen e urdhrit apo dhënien e udhëzimit. Në këtë rast, urdhri apo udhëzimi nxirret nga prokurori më i vjetër në detyrë, drejtor në strukturën e Prokurorisë së Përgjithshme”.

Në referim të dosjes penale të vitit 2015, çështje e hetuar nga vetë subjekti i rivlerësimit (por edhe në dy procedimet e tjera, kur subjekti ka qenë në cilësinë e titullarit dhe ka miratuar vendimet e prokurorëve më të ulët), Komisioni në dosjen penale, nuk evidentoi të kishte një kërkesë të tillë drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme, apo urdhër a udhëzim për të vlerësuar një situatë të mundshme konflikti interesi.

Kodi i Procedurës Penale, në nenin 17 të tij “heqja dorë”, parashikon: *“Gjyqtari ka për detyrë të heqë dorë nga gjykimi i çështjes konkrete, sipas pikës “ë”, kur ekzistojnë shkaqe të tjera të rëndësishme njëanshmërie.”*

Në referencë të dispozitave ligjore të mësipërme, subjekti i rivlerësimit, në momentin që i ishte caktuar të hetonte çështjen, ku personi i proceduar ishte shtetasi I.M., duhej të deklaronte situatën e konfliktit të interesit. Komisioni, për sa i përket dokumentacionit të këtij procedimi penal, ka konstatuar se:

- Subjekti i rivlerësimit nuk ka marrë ndonjë veprim administrativ për të njoftuar me shkrim Prokurorin e Përgjithshëm për gjendjen në situatën e konfliktit të interesit, referuar faktit të njohjes 26-vjeçare dhe miqësisë në rritje me shtetasin I.M., në lidhje me çështjen penale të vitit 2015, ku subjekti ishte prokurori i çështjes.
- Referuar nenit 17 të Kodit të Procedurës Penale “dorëheqja e gjyqtarit”, që është e njëjtë me dorëheqjen e prokurorit, ku pika “ë” parashikon *arsye serioze njëanshmërie*, subjekti nuk e ka respektuar këtë dispozitë, duke mos hequr dorë nga hetimi i kësaj çështjeje, referuar faktit që me shtetasin I.M., kishte njohje dhe miqësi të hershme 26-vjeçare (duke e pasur në vitin 2016, duke i dhënë shumën prej 14,000 euro), fakt ky që përbën shkak ligjor për heqje dorë nga hetimi i çështjes në ngarkim të këtij shtetasi, duke deklaruar konfliktin apo papajtueshmërinë e detyrës së tij me këtë rast.

Subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës nga Komisioni, ka shpjeguar: *“...shtetasin I.M., e njoh që në vitin 1993 si banor i Gjirokastrës... Kam pasur marrëdhënie korrekte dhe në asnjë rast nuk kam pasur raporte të tilla që më kushtëzonin në ushtrimin e detyrës si prokuror në lidhje me problematikat që mund të kishte ky person apo që mund të dilnin. Në këto kushte kur janë filluar procedimet penale, kam qenë në po ato raporte dhe nuk kam pasur asnjë shkak njëanshmërie si ato që përcaktohen në nenet 15, 16 dhe 17 të Kodit të Procedurës Penale, nga momenti që huan nga I.M., e kam marrë në muajin gusht të vitit 2016.”*

Konkluzion

Komisioni, pasi analizoi dokumentacionin e vënë në dispozicion nga institucionet, shpjegimet e subjektit dhe ato të shtetasit I.M., si dhe dokumentacionin e administruar gjatë hetimit, krijoi bindjen se subjekti i rivlerësimit dhe shtetasi I.M., kanë pasur njohje të hershme dhe lidhje miqësore dhe interesi.

Pavarësisht këtij fakti, subjekti i rivlerësimit ka hetuar në një rast drejtpërdrejt kallëzimin penal ndaj shtetasit I. M. (në vitin 2015) dhe në dy raste të tjera (vitet 2014 dhe 2015) në cilësinë e drejtuesit të institucionit, dhe ai nuk ka ndërmarrë asnjë nga veprimet e parashikuara nga legjislacioni në fuqi për ndodhjen në situata të mundshme apo faktike të konfliktit të interesit.

Nga vlerësimi i materialeve në dosje, por edhe nga shpjegimet e subjektit në rezultatet e hetimit dhe në seancën dëgjimore, nuk është vërejtur ndonjë rrethanë që favorizon drejtpërdrejt shtetasin I. M. dhe nuk është provuar ndonjë ndikim i mundshëm i subjektit të rivlerësimit në këto procedime penale, pavarësisht këtij fakti në vijim të logjikës, Komisioni vlerëson se marrëdhënia mes subjektit të rivlerësimit dhe shtetasit I.M., dhe veçanërisht ajo e

huas në vitin 2016, në tërësinë e saj, nuk është një marrëdhënie korrekte, pasi ajo vë në dyshim veprimtarinë profesionale të subjektit të rivlerësimit dhe cenon besimin e publikut tek sistemi i drejtësisë.

Konkluzion përfundimtar për vlerësimin profesional

Nga vlerësimi i dokumenteve ligjorë kanë rezultuar disa mangësi profesionale të subjektit të rivlerësimit gjatë hetimit.

Në lidhje me situatën e konfliktit të interesit konstatohet se të paktën në një rast subjekti i rivlerësimit ka vepruar në kushtet e konfliktit të interesit.

Nga vlerësimi tërësor i kriterit profesional janë konstatuar mangësi dhe problematika, por trupi gjykues vlerëson se ato nuk janë deri në atë masë që të plotësojnë qëllimin e nenit E të Aneksit të Kushtetutës, apo pikës 4, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtareve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, **në vlerësimin e përgjithshëm të tri kritereve** arrin në përfundimin se pavarësisht se nuk u vlerësua që problematikat e konstatuara për secilin komponent përbëjnë më vete shkak për shkarkim nga detyra, duke u analizuar në tërësinë e tyre, në vlerësim të Komisionit, konsiderohet se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut tek drejtësia.

Në përfundim, mbështetur në pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtareve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioni bëri vlerësimin përfundimtar të subjektit të rivlerësimit, z. Arben Pasho, në vlerësimin e përgjithshëm të të tria kritereve, nga ku rezultoi se subjekti i rivlerësimit, me veprimet dhe mosveprimet e tij, ka cenuar besimin e publikut tek sistemi i drejtësisë.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, dhe në bazë të pikës 2, të nenit 4, pikës 1, germa c, të nenit 58, pika 2 të nenit 59 dhe të pikës 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Arben Pasho, me funksion prokuror/drejtues i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë.
2. Vendimi i arsyetuar me shkrim u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.

3. Ky vendim mund të ankimohehet në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 16.05.2019

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Valbona SANXHAKTARI
Kryesuese

Olsi KOMICI
Relator

Roland ILIA
Anëtar

Sekretare gjyqësore
Etmonda Hoxha

P/Gledis Hajdini